



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Financave - Ministry of Finance
Ministarstvo Finansije

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01/2016
PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 05/L-028 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO.01/2016
IMPLEMENTING THE LAW NO.05/L-028 ON PERSONAL INCOME TAX

ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO BR. 01/2016 O SPROVOĐENJU ZAKONA
BR. 05 / L-028 O POREZU NA LIČNI DOHODAK

<p>Ministri i Financave,</p> <p>Në mbështetje të nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-028 për Tatimin në të Ardhura Personale (Gazeta Zyrtare, Nr.22/14.08.2015), nenit 8, nënparagrafit 1.4 të Rregullores Nr.02/2011 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38, paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare, Nr.15/12.09.2011),</p> <p>Nxjerrë:</p> <p>UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01 / 2016 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 05/L-028 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kriteret dhe procedurat për zbatimin e dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.</p>	<p>Minister of Finance,</p> <p>Pursuant to Article 49 of Law no.05/L-028 on Personal Income Tax (Official Gazette No.22/14.08.2015), Article 8, paragraph 1.4 of Regulation no.02/2011 on areas and administrative responsibilities of the Prime Minister's Office and Ministries, as well as Article 38, paragraph 6 of the Government's Rules of Procedure no. 09/2011 (Official Gazette, No. 15/12.09.2011)</p> <p>Issues:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO.01/2016 IMPLEMENTING THE LAW NO.05/L-028 ON PERSONAL INCOME TAX</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>This Administrative Instruction shall define the criteria and procedures for the implementation of the provisions of Law no. 05/L-028 on Personal Income Tax.</p>	<p>Ministarstvo finansija,</p> <p>Na osnovu člana 49. Zakona br. 05 / L-028 o porezu na lične dohotke (Službeni glasnik br. 22/14.08.2015), član 8. Pod - stav 1.4 Uredbe br. 02/2011 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, kao i član 38, stav 6 Poslovnika o radu Vlade br. 09/2011 (Službeni glasnik, br 15 / 12.09.2011).</p> <p>Izdaje:</p> <p>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO BR. 01/2016 O SPROVOĐENJU ZAKONA BR. 05 / L-028 O POREZU NA LIČNI DOHODAK</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>Preko ovog Administrativnog uputstva definisani su kriterijumi i procedure za sprovođenje odredaba Zakona br. 05 / L-028 o porezu na lični dohodak.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të obligueshme për Administratën Tatimore të Kosovës dhe për të gjithë personat që janë në fushëveprimin e Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p> <p>The provisions of this Administrative Instruction shall be mandatory for the Tax Administration of Kosovo and all persons who fall under the scope of the Law no. 05/L-028 on Personal Income Tax.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p> <p>Odredbe ovog Administrativnog uputstva obavezne su za Poresku administraciju Kosova i za sva lica koja spadaju u delokrug Zakona Br. 05/L-028 o porezu na lične dohotke.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin e njëjtë ashtu siç janë përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.</p> <p>2. Për qëllim të këtij Udhëzimi Administrativ, përveç përkufizimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, përdoren edhe përkufizimet e mëposhtme:</p> <p>2.1. Punëdhënës kryesor – punëdhënës i përcaktuar nga i punësuari si i tillë sipas kushteve të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ;</p> <p>2.2. Të ardhurat e tjera – të gjitha të ardhurat që nuk janë cituar në mënyrë specifike në nenin 7 të Ligjit dhe që përfshijnë shpërblime të dhëna jo në para si gjësende, falja e borxhit dhe të ngjashme, të cilat e rrisin pasurinë e</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. Terms and expressions used in this Administrative Instruction shall have the same meaning as defined by Law no. 05/L-028 on Personal Income Tax.</p> <p>2. For the purpose of this Administrative Instruction, in addition to the definitions referred to in paragraph 1 of this Article, the following definitions are used:</p> <p>2.1. Principal employer – the employer designated by the employee as such under the terms defined in this Administrative Instruction;</p> <p>2.2. Other income – all income not specifically cited in Article 7 of the Law and which include non-monetary rewards as things, debt forgiveness and similar, which increase the taxpayer’s wealth;</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Izrazi upotrebljeni u ovom Administrativnom Uputstvu imaju isto značenje kao što je definisano Zakonom br. 05 / L-028 o porezu na lični dohodak.</p> <p>2. Za potrebe ovog administrativnog uputstva, pored definicija iz stava 1. ovog člana, koriste se i dolenađene definicije:</p> <p>2.1. Glavni poslodavca – poslodavac određen od strane zaposlenog kao takav prema uslovima određenim u ovom Administrativnom uputstvu;</p> <p>2.2. Ostali prihodi – svi prihodi koji nisu posebno navedeni u članu 7. Zakona i koji obuhvataju ne – novčane nagrade kao što su stvari, opraštanje dugova i slično, što povećava imovinu poreskog obveznika;</p>

<p>tatimpaguesit;</p> <p>2.3. Ligji – Ligji Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale;</p> <p>2.4. Kontraktues jo vendor - kontraktuesi i vendosur jashtë Republikës së Kosovës;</p> <p>2.5. Projektet dhe kontratat afatgjate ndërtimore – projekte dhe kontrata ndërtimore që kanë shtrirje në dy apo më tepër periudha tatimore;</p> <p>2.6. Punëkryes – personi që kryen punën ndërtimore, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes nënkontraktorëve, i cili paguhet nga investitori që paguan në mënyrë progresive për punën ndërtimore, përmes kombinimit të pagesave të avancit, pagesave progresive dhe pagesave finale;</p> <p>2.7. Investitor – personi që financon punën e kontratës ndërtimore dhe paguan punëkryesin për punën e kryer;</p> <p>2.8. Investitori-Punëkryes – personi që vetëfinancon dhe kryen punën ndërtimore;</p>	<p>2.3. Law - Law no. 05/L-028 on Personal Income Tax;</p> <p>2.4. Non-local contractor – a contractor outside the Republic of Kosovo;</p> <p>2.5. Long-term contracts and construction projects - construction projects and contracts spread out in two or more tax periods;</p> <p>2.6. Constructors- the person who carries out construction work, either directly or through subcontractors, to be paid by the investor who pays progressively for construction work, by combining advance payments, progress payments and final payments;</p> <p>2.7. Investor - a person who finances the work stemming out of construction contract and pays the contractor for the work performed;</p> <p>2.8. Investor-constructor- a person who self-finances and performs construction;</p>	<p>2.3. Zakon – Zakon Br. 05/L-028 o porezu na lične dohotke;</p> <p>2.4. Ne – domaći ugovarači - ugovarač koji se nalazi van Republike Kosova;</p> <p>2.5. Dugoročni građevinski projekti i ugovori – projekti i građevinski ugovori koji se protežu u dva ili više poreskih perioda;</p> <p>2.6. Izvršilac radova – lice koje obavlja građevinske radove, bilo na direktan način ili preko podizvođača, koji se plaćaju od strane investitora koji plaća postepeno (progresivno) za građevinske radove, preko kombinacije isplate avansa, progresivne isplate i konačne isplate;</p> <p>2.7. Investitor – osoba koja finansira radove građevinskog ugovora i plaća izvođača za izvršene radove;</p> <p>2.8. Investitor – Izvršilac radova – osoba koja sama finansira i obavlja građevinske radove;</p>
--	--	---

<p>2.9. Qiradhënës – si palë e lizingut financiar është personi që ka dhe ruan të drejtën e pronësisë mbi mallin dhe që i jep qiramarrësit të drejtën të mbajë dhe të përdorë pasurinë gjatë afatit të kontratës së qirasë sipas kushteve të përcaktuara në kontratë;</p> <p>2.10. Qiramarrës – si palë e lizingut financiar është personi i cili mund të fitojë të drejtën e pronësisë pasi ka mbajtur në përdorim pasurinë gjatë afatit të kontratës së qirasë dhe pasi ka shlyer të gjitha pagesat e qirasë dhe çmimin përfundimtar të blerjes, i cili është i paracaktuar, që qiramarrësi paguan pas përfundimit të afatit të kontratës së qirasë, kur ose nëse vendos ta blejë pasurinë;</p> <p>2.11. Furnizues – për aspekte të lizingut financiar është personi i cili në bazë të kontratës së furnizimit që lidh me qiradhënësin për pasurinë e përzgjedhur nga qiramarrësi në përputhje me përcaktimet e qiramarrësit dhe me kushtet e miratuara prej tij, me anë të së cilës qiradhënësi fiton të drejtën e pronësisë mbi atë pasuri, i shtet qiradhënësit pasurinë që i jepet me qira qiramarrësit;</p> <p>2.12. I huaj - një individ i cili nuk është rezident i rregullt i Kosovës dhe i cili</p>	<p>2.9. Lessor - as financial lease party is a person who has and retain the right of ownership of the goods and that gives Lessees the right to retain and use the property during the term of the lease under the conditions specified in the contract;</p> <p>2.10. Lessee – as financial lease party is a person who can acquire the right of ownership as held in use of the property during the term of the lease and after the settlement of lease payments and the final price of the acquisition, which is the default paid by Lessee after the expiry of the lease, when or if it decides to acquire the property;</p> <p>2.11. Supplier – for aspects of financial leasing, is a person who on the basis of the supply contract entered into with the lessor for the property selected by the lessee in accordance with the Lessee’s determinations and conditions approved by him, by which the lessor acquires the ownership right of that property, sells the property to lessor was leased to Lessees;</p> <p>2.12. Foreigner - a person who is not ordinarily a resident of Kosovo and who</p>	<p>2.9. Zakupodavac – kao stranka finansijskog lizinga je osoba koja ima i zadržava pravo vlasništva robe i koji daje zakupnicima pravo da drže i koriste imovinu tokom trajanja ugovora o zakupu pod uslovima navedenim u ugovoru;</p> <p>2.10. Zakupnik – kao stranka finansijskog lizinga je osoba koja može dobiti pravo vlasništva nakon što je držao na korišćenje imovinu tokom trajanja ugovora o zakupu i nakon što je izmirio sve isplate zakupa i konačnu cenu kupovine, koja je utvrđena, koju zakupnik plaća nakon završetka roka ugovora, kada i ako odluči da kupi imovinu;</p> <p>2.11. Snabdevač – za aspekte finansijskog lizinga je lice koje na osnovu ugovora o snabdevanju koji sklapa sa zakupodavcem za odabranu imovinu od zakupnika u skladu sa opredeljenjem zakupnika i odobrenim uslovima od njega, putem kojih zakupodavac dobija pravo vlasništva na tu imovinu, prodaje zakupodavcu imovinu koja se daje pod zakup zakupniku;</p> <p>2.12. Stranac – pojedinac koji nema stalni boravak na Kosovu i koji nije</p>
--	--	---

<p>nuk është regjistruar në regjistrin e shtetasve që kërkohet të mbahet sipas legjislacionit në fuqi për shtetësinë e Kosovës.</p> <p>2.13. LIFO – nënkupton evidencën e stokut sipas parimit: çmimi i fundit hyrës është çmimi i parë dalës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Pasuria kapitale</p> <p>1. Pasuri kapitale - trajtohet pasuria e prekshme apo e paprekshme, vlera e së cilës është mbi njëmijë euro (1.000€) me afat të përdorimit më të gjatë se një (1) vit.</p> <p>1.1. Për aspekte të Ligjit, pasuria, vlera e së cilës është deri në njëmijë euro (1.000€), e cila nuk mund të funksionojë si e vetme, trajtohet si pasuri kapitale, nëse vlera e tërësisë kalon mbi njëmijë euro (1.000€).</p> <p>1.2. Pasuria, vlera e së cilës është deri në njëmijë euro (1.000€) me afat të përdorimit më të gjatë se një (1) vit, tatimpaguesi mund ta trajtojë si pasuri kapitale.</p>	<p>is not registered in the register of citizens required to be kept under legislation on Kosovo’s statehood.</p> <p>2.13. LIFO – shall mean evidence of the stock according to the principle: the last price in is the first price out.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Capital assets</p> <p>1. Capital assets - cover tangible and intangible property that costs more than one thousand (€1,000) with the term of use for more than one (1) year.</p> <p>1.1. For aspects of the Law, the assets, whose value is up to one thousand euro (€1,000), which may not function as a single, treated as capital assets, if the total value exceeds over one thousand euro (€1,000).</p> <p>1.2. Assets, whose value is up to one thousand euro (€1,000) with a useful life of more than one (1) year, the taxpayer may treat them as capital assets.</p>	<p>registrovan u registar državljana koji je obavezan prema zakonodavstvu na snazi o državnosti Kosova.</p> <p>2.13. LIFO – podrazumeva evidenciju rezrvi skladišta prema načelu: poslednja ulazna cena je prva izlazna cena.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Kapitalna imovina</p> <p>1. Kapitalna imovina – smatra se materijalna i nematerijalna imovina, čija vrednost je veća od hiljadu evra (1.000€) sa rokom korišćenja duže od jedne (1) godine.</p> <p>1.1. Sa aspekta Zakona, imovina, čija vrednost je do hiljadu evra (1.000€), koja ne može da funkcioniše samostalno, tretira se kao kapitalna imovina, ako ukupna vrednost prekoračuje hiljadu evra (1.000€).</p> <p>1.2. Imovina, čija vrednost je do hiljadu evra (1.000€) sa rokom korišćenja duže od jedne (1) godine, poreski obveznik je može tretirati kao kapitalnu imovinu.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 5 Prona e patrupëzuar apo e paprekshme</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Intangible assets</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Nematerijalna ili nedodirljiva imovina</p>
<p>1. Për qëllime të Ligjit dhe të këtij Udhëzimi Administrativ, kategori të pronës së patrupëzuar apo të paprekshme, konsiderohen si në vijim:</p> <p>1.1. Patentat, shpikjet, formulat, dizajnet, modelet, sekretet e tregtisë dhe ofrimi i njohurive të veçanta;</p> <p>1.2. Të drejtat e autorit duke përfshirë të drejtat për veprat letrare, kompozimet muzikore ose artistike;</p> <p>1.3. Shenjat tregtare, emrat tregtarë ose emrat e markës;</p> <p>1.4. Të drejtat ekskluzive, licencat, kontratat;</p> <p>1.5. Programet, sistemet, softuerët kompjuterik; dhe</p> <p>1.6. Të drejtat e tjera të ngjashme.</p>	<p>1. For the purposes of this Law and Administrative Instruction, the category of intangible assets covers the following:</p> <p>1.1. patents, inventions, formulae, processes, designs, patterns, trade secrets and know-how;</p> <p>1.2. copyrights including rights relating to literary, musical, or artistic compositions;</p> <p>1.3. trademarks, trade names, or brand names;</p> <p>1.4. franchises, licenses or contracts;</p> <p>1.5. programs, systems, computer software; and</p> <p>1.6. other similar rights.</p>	<p>1. Za potrebe ovog Zakona i ovog Administrativnog uputstva, kao kategorija nematerijalne ili nedodirljive imovine, smatra se imovina kao u nastavku:</p> <p>1.1. Patenti, pronalasci, formule, dizajni, modeli, poslovne tajne i pružanje specifičnih znanja;</p> <p>1.2. Autorska prava uključuju prava za književna dela, muzičke kompozicije ili umentičke;</p> <p>1.3. Zaštitni znakovi, trgovačka imena ili imena marke;</p> <p>1.4. Ekskluzivna prava, licence, ugovori;</p> <p>1.5. Programi, sistemi, kompjuterski softueri; i</p> <p>1.6. Druga slična prava.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 6 I punësuari</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 An employee</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Zaposleni</p>
<p>1. Për qëllim të këtij Udhëzimi Administrativ, ashtu siç është përcaktuar me Ligj, i punësuar konsiderohet personi fizik jo afarist, i cili kryen punë kundrejt pagesës sipas urdhrit dhe nën kontrollin e një punëdhënësi. Personi fizik jo afarist pavarësisht thirrjes, si: “drejtor”, “zyrtar”, “parlamentar”, “ministër”, “nëpunës” etj., konsiderohet se është i punësuar nëse përmbush së paku dy nga kushtet, si në vijim:</p> <p>1.1. I punësuar nuk është në rrezik për marrjen e pagesës, pavarësisht rezultatit afarist të punëdhënësit,</p> <p>1.2. I punësuar nuk ka nevojë të investojë në instrumentet e punës, mjetet dhe pajisjet,</p> <p>1.3. I punësuar nuk e përcakton vendin dhe kohën e punës, dhe</p> <p>1.4. Si rregull i përgjithshëm, një i punësuar ka të përcaktuar një punëdhënës kryesor.</p>	<p>1. For the purpose of this Administrative Instruction, as defined by law, an employee is considered a non-business natural person, who performs work for wages under the direction and control of an employer. Natural non-business person despite the title “director”, “official”, “parliamentarian”, “minister”, “clerk”, etc., is considered employed if it meets at least two of the conditions, as follows:</p> <p>1.1. An employee is not at risk for receiving payment, regardless of the employer’s business outcome,</p> <p>1.2. An employee does not need to invest in working instruments, tools and equipment,</p> <p>1.3. An employee does not determine the place and time of work, and</p> <p>1.4. As a general rule, an employee has one principal employer.</p>	<p>1. Za potrebe ovog Administrativnog uputstva, kako je definisano zakonom, zaposleni se smatra fizičko lice ne poslovno, koji obavlja posao za platu pod upravom i kontrolom poslodavca. Fizičko ne poslovno lice uprkos nazivu kao "direktor", "zvaničnik", "parlamentarac", "ministar", "službenik", itd, smatra se zaposlenim ako ispunjava najmanje dva uslova, kao što je dole navedeno:</p> <p>1.1. Zaposleni nije ugrožen što se tiče primanja plate, bez obzira na poslovne rezultate poslodavca,</p> <p>1.2. Zaposleni nema potrebe da investira u radne instrumente, alate i opremu,</p> <p>1.3. Zaposleni ne određuje mesto i vreme rada, i</p> <p>1.4. Kao opšte pravilo, jedan zaposleni ima jednog određenog glavnog poslodavca.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 7 Punëdhënësi kryesor</p> <p>1.I punësuari, nëse punon për një apo më tepër punëdhënës, cakton një punëdhënës kryesor.</p> <p>2.I punësuari nuk mund të ketë më shumë se një punëdhënës kryesor në të njëjtën kohë.</p> <p>3.I punësuari cakton punëdhënësin kryesor brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e fillimit të punësimit apo ndërrimit të punëdhënësit kryesor, duke plotësuar dhe dorëzuar në ATK, Formularin e Caktimit të Punëdhënësit Kryesor, në formatin e përcaktuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Principal employer</p> <p>1.An employee, whether working for one or more employers, shall designate a principal employer.</p> <p>2.An employee cannot have more than one principal employer at the same time.</p> <p>3.An employee shall designate a principle employer within fifteen (15) days from the date commencing employment or change of principal employer by filing out and submitting, the Principal Employer Designation form to TAK, in the format prescribed by the Tax Administration of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Glavni poslodavac</p> <p>1.Zaposleni, ako radi za jednog ili više poslodavaca, određuje jednog glavnog poslodavca.</p> <p>2.Zaposleni ne može imati više od jednog glavnog poslodavca u isto vreme.</p> <p>3.Zaposleni određuje glavnog poslodavca u roku od petnaest (15) dana od dana početka zaposlenja ili promene glavnog poslodavca, popunjavajući i predajući u PAK, obrazac za određivanje glavnog poslodavca, u formatu koji je određen od Poreske administracije Kosova.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Rezidenti</p> <p>1. Për qëllim të këtij Udhëzimi Administrativ, ashtu siç është përcaktuar me Ligj, Rezident konsiderohet personi apo grupi i personave që është i themeluar në Kosovë ose që ka vendin e vet të menaxhimit efektiv në Kosovë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Resident</p> <p>1. For the purpose of this Administrative Instruction, as defined by law, Resident is regarded person or group of persons established in Kosovo or has its place of effective management in Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Rezident</p> <p>1.Za potrebe ovog Administrativnog uputstva, kao što je definisano zakonom, rezident se smatra lice ili grupacija osoba koja je osnovana na Kosovu ili koji imaju svoje mesto efektivnog upravljanja na Kosovu.</p>

<p>1.1. Personi fizik konsiderohet rezident kosovar për qëllime tatimore, nëse është i pranishëm në Kosovë gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore, në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, në total më tepër se njëqindetëdhjetetë (183) ditë, pavarësisht nga shtetësia apo vendi ku ka interesat jetike. Në llogaritjen e kohës së qëndrimit në Kosovë, përfshihen ditët e prezencës fizike, pra jo vetëm ditët e punës por edhe ditët e mbërritjes, largimit dhe pushimet. Rezident tatimor kosovar, konsiderohet çdo person fizik që plotëson njërin ose të dy kriteret e sipërpërmendura (kriterin e vendbanimit dhe kriterin e kohëzgjatjes së qëndrimit).</p> <p>1.2. Ndërmarrja afariste personale, ortakëria apo shoqëria e personave, konsiderohet rezident tatimor në Kosovë, nëse:</p> <p>1.2.1. Është e themeluar në Kosovë, ose</p> <p>1.2.2. Ka vendin e menaxhimit (drejtimit) efektiv të biznesit në Kosovë.</p> <p>1.3. Bazuar në nenin 4, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit, personi rezident tatimor kosovar tatóhet në Kosovë për të gjitha të ardhurat me burim në Kosovë dhe jashtë saj, ndërsa personi jo rezident</p>	<p>1.1. A natural person is considered a resident of Kosovo for tax purposes, if present in Kosovo during a period of twelve (12) months, continuously or intermittently, in total more than one hundred eighty (183) days, regardless of the nationality or the place where his vital interests are. When calculating the period of stay in Kosovo, the days of physical presence are considered, not only the working days but the days of arrival, departure and holidays. Kosovar tax resident is considered a natural person who meets one or both of the above criteria (criteria of residence and length of stay criteria).</p> <p>1.2. Personal business enterprise, partnership, or association of persons are considered tax resident in Kosovo if:</p> <p>1.2.1. Established in Kosovo, or</p> <p>1.2.2. It has its place of effective business management in Kosovo.</p> <p>1.3. Pursuant to Article 4, paragraphs 1 and 2 of the Law, the taxable Kosovar resident is subject to taxation in Kosovo on all income sourced in Kosovo and abroad, while non-resident person in</p>	<p>1.1. Fizičko lice se smatra rezident Kosova za poreske ciljeve, ako je prisutan na Kosovu tokom perioda od dvanaest (12) meseci, stalno ili sa prekidima, ukupno više od sto osamdeset tri (183) dana, bez obzira na državljanstvo ili zemlju gde ima životne interese. U izračunavanju vremena koje je proveo na Kosovu, obuhvaćeni su dani fizičkog boravka, dakle ne samo poslovni dani već i dani dolaska, odlaska i odmor. Poreski rezident Kosova, smatra se bilo koje fizičko lice koji ispunjava jedan ili oba gore spomenuta kriterijuma (kriter boravka i dužina boravka).</p> <p>1.2. Lično poslovno preduzeće, partnerstvo ili udruženje osoba, smatra se rezidentom Kosova, ako:</p> <p>1.2.1. Je osnovano na Kosovu, ili</p> <p>1.2.2. Mesto upravljanja (rukovođenje) biznisa je na Kosovu.</p> <p>1.3. Na osnovu člana 4, stav 1 i 2 zakona, kosovsko poresko rezidentno lice oporezuje se na Kosovu za sve prihode sa izvorom na Kosovu i van njega, dok ne rezidentno lice oporezuje</p>
--	---	---

<p>tatohet në Kosovë vetëm për të ardhurat me burim në Kosovë.</p> <p>1.4. Për personin që është rezident në vendet me të cilat Kosova ka nënshkruar Marrëveshje për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD) dhe parandalimin e evazionit fiskal, si dhe këto marrëveshje janë në fuqi dhe janë të zbatueshme, aplikohen dispozitat e këtyre marrëveshjeve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Njohja e të ardhurave të tatueshme</p> <p>1. Varësisht nga mënyra e tatuarjes, njohja e të ardhurave të tatueshme bëhet si në vijim:</p> <p>1.1. Për bizneset që i nënshtrohen tatuarjes në të ardhurat reale, metodë e kontabilitetit është metoda akruale, të ardhurat raportohen në periudhën tatimore kur janë furnizuar mallrat apo kur janë ofruar shërbimet.</p> <p>1.2. Për bizneset që nuk i nënshtrohen tatuarjes në të ardhura reale, metodë e kontabilitetit është ajo me para të gatshme, të ardhurat raportohen në periudhën tatimore kur janë pranuar paratë.</p>	<p>Kosovo is taxed only on income sourced in Kosovo.</p> <p>1.4. For person who is resident in countries with which Kosovo entered into Agreements for the Elimination of Double Taxation (AEDT) and the prevention of fiscal evasion, and these agreements are in force and applicable, provisions of these agreements shall apply.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 The recognition of taxable income</p> <p>1. Depending on the method of taxation, recognition of taxable income is determined as follows:</p> <p>1.1. For businesses subject to real income taxation, the method of accounting is the accrual method, income is reported in the tax period when the goods are supplied or services are provided.</p> <p>1.2. For businesses which are not subject to real income taxation, accounting method is cash based whereby income tax is reported in the period when the money is received.</p>	<p>se na Kosovë samo za prihode čiji izvor je na Kosovu.</p> <p>1.4. Za osobu koja je rezident u zemljama sa kojima je Kosovo potpisalo Sporazum za uklanjanje dvostrukog poreza (SEDP) i sprečavanje utaje poreza, i da su ovi sporazumi na snazi i sprovodljivi, i da se primenjuju odredbe ovih sporazuma.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Priznavanje oporezivog dohotka</p> <p>1. U zavisnosti od načina oporezivanja, priznavanje oporezivog dohotka utvrđuje se kao što sledi:</p> <p>1.1. Za preduzeća koja su predmet oporezivanja realnog dohotka, metoda računovodstva je obračunski metod (akrualni), prihodi se prijavljuju u poreskom periodu kada se roba isporučuje ili kada se usluge pružaju.</p> <p>1.2. Za preduzeća koja nisu predmet oporezivanja u realnim prihodima, metoda računovodstva je gotovinski način, poreski prihodi se prijavljuju u periodu kada je dobijen novac.</p>
--	--	--

<p align="center">Neni 10 Të ardhurat bruto</p>	<p align="center">Article 10 Gross income</p>	<p align="center">Član 10 Bruto prihodi</p>
<p>1. Neni 7, paragrafi 1 i Ligjit, definojnë të ardhurat bruto të cilat janë pranuar me të vërtetë dhe në mënyrë konstruktive nga një varg i burimeve. Në lidhje me burimet e mëposhtme, shprehja "të pranuar me të vërtetë dhe në mënyrë konstruktive" ka kuptimin si në vijim:</p> <p>1.1. Pagat zakonisht paguhen një apo më shumë herë në muaj edhe pse shërbimet e punësimit kryhen në baza ditore.</p> <p>1.1.1. E ardhura nga paga përfshihet në të ardhurat bruto të periudhës tatimore në të cilën paga është paguar nga punëdhënësi dhe është pranuar nga i punësuar.</p> <p>1.1.2. Çdo pjesë përbërëse e "pagave" që nuk është paguar në para të gatshme, gjithashtu përfshihet në të ardhurat bruto të periudhës tatimore në të cilën është pranuar kjo komponentë.</p> <p>1.2. Të ardhurat nga dhënia me qira e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, raportohen si në vijim:</p>	<p>1. Article 7, paragraph 1 of the Law defines gross income that have been actually received and constructively from a range of sources. With regard to the following, the expression "truly and constructively received" shall have the following meaning:</p> <p>1.1. Wages are usually paid one or more times per month although the employment services are rendered on a daily basis.</p> <p>1.1.1. Income from wages is included in the gross income of the tax period in which the wage is paid by the employer and received by the employee.</p> <p>1.1.2. Every component of "wages" not paid in cash is also included in the gross income of the tax period in which this component was received.</p> <p>1.2. Income from leasing movable and immovable assets shall be reported as follows:</p>	<p>1. Član 7, stav 1 Zakona, definiše bruto prihode koji su stvarno i na konstruktivan način primljeni iz niza raznih izvora. Što se tiče sledećih izvora, izraz "prihod primljen zaista i na konstruktivan način" ima značenje kao što sledi:</p> <p>1.1. Plate se obično plaćaju jednom ili više puta mesečno iako se usluge zapošljavanja vrše na dnevnoj osnovi.</p> <p>1.1.1. Prihodi od plata obuhvaćeni su u bruto prihode poreskog perioda kada je plata isplaćena od poslodavca i kada je primljena od zaposlenog.</p> <p>1.1.2. Svaki sastavni deo "plata" koji nije isplaćen u gotovini, takođe je obuhvaćen u bruto prihode poreskog perioda kada je primljena ta komponenta.</p> <p>1.2. Prihodi od davanja pod zakup pokretne i nepokretne imovine, prijavljuju se kao što sledi:</p>

<p>1.2.1. Tatimpaguesi që nuk i nënshtrohet tatuarjes në të ardhura reale, të ardhurat nga qiraja, i raporton në periudhën kur këto të ardhura janë pranuar;</p> <p>1.2.2. Tatimpaguesi që i nënshtrohet tatuarjes në të ardhura reale, të ardhurat nga qiraja, i raporton në bazë të parimit akrual;</p> <p>1.2.3. Sipas nenit 11, paragrafit 2 të Ligjit, tatimpaguesi që zhvillon aktivitet të dhënies me qira të pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme, raporton të ardhurat e tij nga qiraja si të ardhura nga aktiviteti afarist.</p> <p>1.3. E ardhura nga interesi raportohet, si në vijim:</p> <p>1.3.1. Tatimpaguesi që nuk i nënshtrohet tatuarjes në të ardhura reale, të ardhurën nga interesi e raporton në periudhën kur është pranuar;</p> <p>1.3.2. Tatimpaguesi që i nënshtrohet tatuarjes në të ardhura reale, të ardhurën nga interesi e raporton në bazë të parimit akrual;</p>	<p>1.2.1. A taxpayer, who is not subject to taxation on real income, shall report incomes from lease in the period when such income is received;</p> <p>1.2.2. A taxpayer, who is not subject to taxation on real income, shall report incomes from lease on the accrual basis;</p> <p>1.2.3. Pursuant to Article 11, paragraph 2 of the Law, a taxpayer who carries through a leasing of movable or immovable property, shall report its income from lease as income from business activity.</p> <p>1.3. Income from interest is reported as follows:</p> <p>1.3.1. A taxpayer, who is not subject to taxation on real income, shall report income from interest in the period when it is received;</p> <p>1.3.2. A taxpayer, who is subject to taxation on real income, shall report income from interest on the accrual basis;</p>	<p>1.2.1. Poreski obveznik koji ne podleže oporezivanju na realne prihode, prihode od zakupa prijavljuje u periodu kada su ti prihodi primljeni;</p> <p>1.2.2. Poreski obveznik koji podleže oporezivanju na realne prihode, prihode od zakupa prijavljuje na osnovu metode obračunavanja (akrualne);</p> <p>1.2.3. Prema članu 11, stav 2 Zakona, poreski obveznik koji razvija aktivnosti davanja pod zakup pokretne i nepokretne imovine, takođe prijavljuje svoje prihode od zakupa kao poslovna aktivnost.</p> <p>1.3. Prihodi od kamate se prijavljuju kao što sledi:</p> <p>1.3.1. Poreski obveznik koji ne podleže oporezivanju na realne dohotke, prihode od kamate prijavljuje u periodu kada su primljeni;</p> <p>1.3.2. Poreski obveznik koji podleže oporezivanju na realne prihode, prihode od kamate prijavljuje na osnovu metode obračunavanja (akrualne);</p>
---	---	--

<p>1.4. E ardhura nga fitoret në lotari dhe fitoret në lojërat e fatit raportohet në periudhën tatimore në të cilën është pranuar ose kredituar në llogarinë e fituesit.</p> <p>1.5. Të ardhurat e tjera përfshihen në të ardhurat bruto të periudhës tatimore në të cilën janë pranuar. Në rastin e shpërblimeve të dhëna jo në para, pranuesi vlerëson mallrat e pranuar në bazë të vlerës së hapur të tregut.</p>	<p>1.4. From lottery winnings and gambling winnings shall be reported in the tax period in which it was received or credited to the account of the winner.</p> <p>1.5. Other incomes are included in the gross income of the tax period in which they were received. In the case of non-cash awards given, the recipient assesses the goods received on the basis of open market value.</p>	<p>1.4. Prihodi od dobitka na lutriji i igara na sreću prijavljuju se u poreskom periodu kada su primljeni ili kreditirani na račun dobitnika.</p> <p>1.5. Ostali prihodi obuhvaćeni su u bruto prihode poreskog perioda kada su primljeni. U slučaju nagrada datih ne u novcu, primalac procenjuje primljenu robu na osnovu otvorene tržišne vrednosti.</p>
<p>Neni 11 Të ardhurat e përjashtuara</p>	<p>Article 11 Exempted income</p>	<p>Član 11 Izuzeti prihodi</p>
<p>1. Neni 8, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1 deri 1.5 të Ligjit, përcaktojnë se pagat për personelin e huaj, përfaqësuesit e huaj, zyrtarët e huaj, etj., përjashtohen nga Tatimi në të Ardhurat Personale.</p> <p>2. Neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i Ligjit, përjashton nga Tatimi në të Ardhurat Personale, rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm dhe zyrtarëve të punësuar vendor të Kombeve të Bashkuara dhe të agjencive të saj të specializuara dhe Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Atomike. Të njëjtat përjashtime vlejné për institucionet ndërkombëtare financiare ndërqeveritare që kanë të drejtë dhe që janë të autorizuara të veprojnë në Kosovë;</p>	<p>1. Article 8, paragraph 1, sub-paragraphs 1.1 to 1.5 of the Law stipulate that wages for foreign staff, foreign representatives, foreign officials, etc., shall be exempted from personal income tax.</p> <p>2. Article 8, paragraph 1, sub-paragraph 1.4 of the Law exempts from tax on personal income, wages of foreign representatives and officials as well as locally employed officials within the United Nations and its specialised agencies and the International Atomic Energy Agency. The same exemption shall apply to entitled and duly authorised international inter-governmental financial institutions operating in Kosovo;</p>	<p>1. Član 8, stav 1, pod-stav 1.1 do 1.5 Zakona, određuju da su plate za strano osoblje, strane predstavnike, strane zvaničnike itd. izuzete od Poreza na lične dohotke.</p> <p>2. Član 8, stav 1, pod-stav 1.4 Zakona, oslobađa od plaćanja Poreza na lične dohotke, plate spoljnih predstavnika i zvaničnika i domaće zaposlene zvaničnike Ujedinjenih nacija i njenih specijalizovanih agencija i međunarodnih agencija atomske energije. Isto izuzeće važi i za međunarodne međuvladine finansijske institucije koje imaju pravo i koje su ovlašćene da deluju na Kosovu;</p>

<p>3. Kontraktuesi jo-vendor nuk obligohet të regjistrohet në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, por obligohet të njoftoj ATK-në, në formë të shkruar, se është duke punuar në Kosovë.</p> <p>3.1. Kontraktuesi jo-vendor që zhvillon aktivitete të tjera në Kosovë, që janë të ndryshme nga këto në relacion me organizatat e përmendura në këtë nen, regjistrohet në Kosovë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe në ATK. Në ATK regjistrohet duke aplikuar për numrin fiskal ose duke caktuar përfaqësuesin fiskal. Të ardhurat e krijuara nga aktivitetet tjera janë të ardhura të tatueshme.</p> <p>3.2. Kontraktuesi jo-vendor pavarësisht se a ka ndonjë aktivitet tjetër apo jo, është përgjegjës, qoftë në mënyrë direkte ose nëpërmes të përfaqësuesit të tij fiskal, për përmbushjen e çdo obligimi të mbajtjes së tatimit në burim të aplikueshëm të paraparë në Kapitullin IX të Ligjit.</p> <p>4. Për qëllime të Nenit 8, paragrafit 1, nënparagrafit 1.11 të Ligjit, shprehja “organizatat ndërkombëtare ndër-qeveritare”, nënkupton:</p>	<p>3. Non-local contractor is not required to register within the Ministry of Trade and Industry in Kosovo, but required to notify TAK in writing that it is working in Kosovo.</p> <p>3.1. Non-local contractor performs other activities in Kosovo, other than those in relation with the organizations mentioned in those paragraphs, it should register in Kosovo with the Ministry of Trade and Industry and with TAK. It should be registered within TAK either by applying for a fiscal number or by appointing a fiscal representative. Incomes generated from other activities are taxable income.</p> <p>3.2. Such non-local contractors, whether they have other activities or not, are also responsible (whether directly or through their fiscal representative) for meeting any applicable withholding tax obligations provided under Chapter IX of the Law.</p> <p>4. For the purposes of Article 8, paragraph 1, sub-paragraph 1.11 of the Law, the term “international inter-governmental organization” shall mean:</p>	<p>3. Ne-domaći ugovarač nije dužan da se registruje kod Ministarstva trgovine i industrije na Kosovu, ali je dužan da obavesti PAK pismeno da radi na Kosovu</p> <p>3.1. Ne - domaći ugovarač radova koji obavlja i druge poslove na Kosovu, koji se razlikuju od onih u odnosu na pomenute organizacije u ovom članku, registruje se u Ministarstvu trgovine i industrije Kosova i u PAK. U PAK se prijavljuje podnošenjem zahteva za fiskalni broj ili imenovanjem fiskalnog predstavnika. Prihodi od ostalih aktivnosti su oporezivi prihodi.</p> <p>3.2. Ne – domaći ugovarač bez obzira da li postoji neka druga aktinost ili ne, odgovoran je, bilo na direktan način ili putem njegovog fiskalnog predstavnika, za ispunjenje svih obaveza zadržavanja odgovarajućeg poreza po odbitku predviđeno u poglavlju IX ovog zakona</p> <p>4. Za ciljeve člana 8, stav 1, pod-stav 1.11 Zakona, izraz “međunarodne međuvladine organizacije”, podrazumeva:</p>
---	--	---

<p>4.1. Korporata Ndërkombëtare e Financave (IFC) dhe anëtarët tjerë të Grupit të Bankës Botërore;</p> <p>4.2. Banka Ndër-Amerikane për Zhvillim (IADB);</p> <p>4.3. Banka Aziatike për Zhvillim (ADB);</p> <p>4.4. Banka Afrikane për Zhvillim (AFDB)</p> <p>4.5. Banka Islamike për Zhvillim (IDB).</p> <p>5. Neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 i Ligjit, përcakton se paga e personit me nevoja të veçanta, siç parashihet me ligjet përkatëse për këto kategori, është e ardhur e përjashtuar nga Tatimi në të Ardhura Personale.</p> <p>5.1. Paragrafi 5 i këtij neni aplikohet vetëm në rastet kur i punësuarit posedon dëshminë nga autoriteti kompetent, e cila vërteton statusin e tij.</p> <p>6. Pasuria apo vlera e pasurisë së përvetësuar falas, me rastin e ndërrimit të pronarit të biznesit të aprovuar nga ATK, është e ardhur e përjashtuar për përvetësuesin (pronarin e ri) me kusht që pronari i ri të jetë bashkëshort/e apo pasardhës i pronarit (vajza, djali dhe i/e adaptuari), prindi apo pasardhësi i tij (vëllai</p>	<p>4.1. International Finance Corporation (IFC) and other members of the World Bank Group;</p> <p>4.2. The Inter-American Development Bank (IADB);</p> <p>4.3. Asian Development Bank (ADB);</p> <p>4.4. African Development Bank (AFDB)</p> <p>4.5. Islamic Development Bank (IDB).</p> <p>5. Article 8, paragraph 1, sub-paragraph 1:12 of the Law foresees that wages of persons with disabilities as foreseen under relevant laws for these categories are an income exempted from personal income tax.</p> <p>5.1. Paragraph 5 of this Article shall apply only in cases where the employee possesses evidence by the competent authority confirming its status.</p> <p>6. Assets or value of the assets acquired free of charge, when business owner is changed and approved by TAK, is an income excluded for the one acquiring it (the new owner), provided that the new owner is the spouse and/or descendants of owner (daughter, son and adapted), the parent or his successor (brother or sister).</p>	<p>4.1. Međunarodne finansijske korporacije (MFK) i druge članove Grupacija Svetske banke;</p> <p>4.2. Inter- američka razvojna banka (IADB);</p> <p>4.3. Azijska banka za razvoj (ABR);</p> <p>4.4. Afrička banka za razvoj(AFBR)</p> <p>4.5. Islamska banka za razvoj (IBR).</p> <p>5. Član 8, stav 1, pod-stav 1.12 Zakona, predviđa da plata osoba sa posebnim potrebama, kao što je predviđeno odgovarajućim zakonima za ovu kategoriju, je prihod koji je oslobođen od Poreza na lične dohotke.</p> <p>5.1. Stav 5 ovog člana primenjuje se samo u slučajevima kada zaposleni poseduje dokaze nadležnih organa, koji potvrđuju njegov status.</p> <p>6. Imovina, ili vrednost imovine stečene besplatno, prilikom promene vlasnika biznisa odobreno od PAK-a, je prihod izuzet za sticaoca (novi vlasnik) pod uslovom da novi vlasnik bude supružnik/ili naslednik vlasnika (kćerka, sin i /ili usvojeni), roditelj ili njegov naslednik (sestra ili brat).</p>
--	--	--

<p>apo motra).</p> <p>7.Paga e cila i paguhet punëtorit fillestar apo praktikantit, nuk konsiderohet e ardhur e përjashtuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 E ardhura nga kompensimi për shpenzimet e jetesës në një program zyrtar trajnimi</p> <p>1. Për qëllime të nenit 8, paragrafit 1, nënparagrafit 1.18 të Ligjit, shumat maksimale në emër të kompensimit të shpenzimeve të jetesës, të përjashtuara nga Tatimi në të Ardhurat Personale, janë:</p> <p>1.1. Për aspekte të strehimit, domosdoshmërisht të nevojshëm, për shkak të largësisë së vendit të programit të trajnimit nga rezidenca kryesore e personit, ose për shkak të kërkesave për pjesëmarrje në programin e trajnimit:</p> <p>1.1.1. Strehimi brenda Kosovës, 50 euro në ditë;</p> <p>1.1.2. Strehimi jashtë Kosovës, përcaktuar me aktin nënligjor nga Ministria e Administratës Publike;</p>	<p>7.The wage paid to beginners or apprentices shall not be considered as exempted income.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Income from reimbursement of subsistence in a formal training program</p> <p>1. For the purposes of Article 8, paragraph 1, sub-paragraph 1.18 of the law, maximum amounts of subsistence expenses available for exemption from personal income tax shall be:</p> <p>1.1. In the case of lodging necessary due to the distance of the training program venue from a person's main residence or due to the requirements of training program attendance</p> <p>1.1.1. lodging within Kosovo, 50 euro per day;</p> <p>1.1.2. lodging outside Kosovo, specified under sub legal act by the Ministry of Public Administration;</p>	<p>7.Plata koja se plaća početnom radniku ili pripravniku, ne smatra se kao izuzeti prihod.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Prihod od nadoknade za životne troškove u službenom programu obuke.</p> <p>1. Za potrebe člana 8, stav 1, podstav 1.18 Zakona, maksimalni iznosi u ime nadoknade životnih troškova, izuzeti od Poreza na lične dohotke, su:</p> <p>1.1. Za potrebe smeštaja, nužno potrebnih, zbog udaljenosti mesta programa obuke od glavnog prebivališta osobe, ili zbog zahteva učešća u programu obuke:</p> <p>1.1.1. Smeštaj unutar Kosova, 50 evra dnevno;</p> <p>1.1.2. Smeštaj van Kosova, određeno podzakonskim aktom od Ministarstva javne administracije;</p>
--	--	--

<p>1.2. Për aspekte të ushqimit:</p> <p>1.2.1. Për programet e trajnimit brenda Kosovës, 15 euro në ditë për programet ditore të trajnimit ose 25 euro në ditë për programet e trajnimit me fjetje;</p> <p>1.2.2. Për programet e trajnimit jashtë Kosovës, përcaktuar me aktin nënligjor nga Ministria e Administratës Publike.</p> <p>1.3. Shuma e kompensimit të shpenzimeve të jetesës që tejkalon limitet e përcaktuara sipas paragrafit 1, nënparagrafëve 1.1 dhe 1.2 të këtij neni, është e ardhur e tatueshme për përfituesin.</p> <p>2. Kompensimi i shpenzimeve të trajnimit të paguara nga një punëdhënës për të punësuarin, për pjesëmarrje në një program trajnimi që nuk ndërlidhet me përshkrimin e vendit të punës, nuk konsiderohet e ardhur e përjashtuar për përfituesin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 E ardhura nga granti, subvencioni dhe donacioni</p> <p>1. E ardhura e përfituar sipas nenit 8, paragrafit 1, nënparagrafit 1.25 të Ligjit,</p>	<p>1.2. In the case of meals:</p> <p>1.2.1. training programs inside Kosovo, 15 euro per day for day-training programs or 25 euro per day for training programs that require staying overnight</p> <p>1.2.2. Training programs outside Kosovo, specified under sub legal act by the Ministry of Public Administration.</p> <p>1.3. The amount of reimbursement for subsistence expenses exceeds the limits set by paragraph 1, sub-paragraphs 1.1 and 1.2 of this article, is taxable income to the beneficiary.</p> <p>2. Reimbursement of training paid by an employer to an employee for participating in a training program that is not related to the job description shall not be considered as an exempted income to the beneficiary.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Income from grants, subsidies and donations</p> <p>1. Income generated according to Article 8, paragraph 1, sub-paragraph 1.25 of the law,</p>	<p>1.2. Aspekti hrane:</p> <p>1.2.1. Za programe obuke unutar Kosova, 15 evra dnevno za dnevne programe obuke ili 25 evra dnevno za programe obuke sa noćenjem;</p> <p>1.2.2. Za program obuke van Kosova, određeno podzakonskim aktom od Ministarstva javne administracije,</p> <p>1.3. Iznos nadoknade životnih troškova koji prekoračuje granice određene u stavu 1, podstav 1.1 i 1.2 ovog člana, je oporezivi prihod za korisnika.</p> <p>2. Naknada troskova obuke plaćena od strane poslodavca za zaposlenog za učešće u programu obuke koji nije povezan sa opisom njegovog radnog mesta, ne smatra se kao izuzet prihod za korisnika.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Prihodi od granta, subvencije i donacije</p> <p>1. Prihodi dobijeni prema članu 8, stav 1, podstav 1.25 Zakona, je izuzet ako je to u</p>
--	---	---

<p>është e përjashtuar nëse është në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit.</p> <p>1.1. Personi fizik afarist i cili tatóhet në bazë të të ardhurave reale, të ardhurat sipas paragrafit 1 të këtij neni i trajton në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit;</p> <p>1.2. Personi fizik jo afaristë dhe personi fizik afarist i cili nuk tatóhet në bazë të të ardhurave reale, të ardhurat sipas paragrafit 1 të këtij neni i trajton të ardhura të përjashtuara dhe nuk i përfshinë në deklaratën tatimore të periudhës.</p>	<p>is exempted if it is in accordance with the terms and conditions of generating it</p> <p>1.1. Natural business person who is taxed on the basis of real income, income under paragraph 1 of this article are handled in accordance with Kosovo Accounting Standards;</p> <p>1.2. Natural non-business person and natural business person who are not taxed on the basis of real income, income under paragraph 1 of this article is handled as exempted income and not included in the tax declaration period.</p>	<p>skladu sa pravilima i uslovima profitabilnosti.</p> <p>1.1. Poslovno fizičko lice koje je oporezovano na osnovu relanih prihoda, prihode prema stavu 1 ovog člana tretira u skladu sa Kosovskim standardima računovodstva;</p> <p>1.2. Ne poslovno fizičko lice koje nije oporezovano na osnovu realnih prihoda, prihode prema stavu 1 ovog člana tretira kao izuzete prihode i ne obuhvata ih u poreskoj izjavi za taj period.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Të ardhurat nga paga</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Income from wages</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Prihodi od plate</p>
<p>1. Bazuar në nenin 9, paragrafin 1, nënparagrafin 1.8 të Ligjit, shuma minimale e përfitimeve në gjësende, mbi të cilën shumë përfitimet e tilla konsiderohen të ardhura bruto nga paga, është gjashtëdhjetepesë (65) euro në muaj. Për shembull, nëse një i punësuar merr nga punëdhënësi përfitime në natyrë në formë të gjësendeve prej nëntëdhjetë (90) euro në muaj, shuma prej njëzetepesë (25) euro e cila tejkalon maksimumin e përcaktuar prej gjashtëdhjetepesë (65) euro, përfshihet në</p>	<p>1. Pursuant to article 9, paragraph 1, subparagraph 1.8 of the Law, the minimum amount of benefits in things above which such benefits will be regarded as gross income from wages shall be sixty-five (65) euro per month. For example, if an employee receives from an employer in-kind in benefits of ninety (90) euros per month, the amount of twenty-five (25) euro, which exceeds the maximum set of sixty-five (65) Euros shall be included in gross income from wages.</p>	<p>1. Na osnovu člana 9, stav 1, podstav 1.8 Zakona, minimalni iznos dobitka na stvari, na koji iznos takve naknade se smatraju kao bruto prihodi od plate, je šezdeset pet (65) evra mesečno. Na primer, ako jedan zaposleni uzima od poslodavca razne beneficije u naturi u vidu raznih stvari od devedeset (90) evra mesečno, iznos od dvadeset pet (25) evra koji prekoračuje utvrđeni maksimum šezdeset pet (65) evra, obuhvaća se u bruto prihode od plata.</p>

<p>1. Për qëllime të aplikimit të vlerës së hapur të tregut kur shitjet e asetëve kapitale janë bërë në mes personave të lidhur dhe janë më të ulëta se vlera e hapur e tregut, kjo vlerë përcaktohet si:</p> <p>1.1. Shuma monetare e parashikuar për një shitje të asetit të njëjtë në mes të blerësit të vullnetshëm dhe shitësit të vullnetshëm në një transaksion të mbizotërimit të tregut;</p> <p>1.2. Shuma që do të jetë rezultat i shitjes së një asemi të ngjashëm në rrethana të ngjashme (p.sh. cilësi të ngjashme, madhësi të ngjashme ose periudhë kohore dhe kushte të njëjta të shitjes);</p> <p>1.3. Kur nuk mund të aplikohen nënparagrafet 1.1. dhe 1.2. të këtij neni, aplikohet metoda e miratuar nga ATK, e cila siguron një përafrim të mjaftueshëm objektiv.</p> <p>2. Për qëllime të nenit 31, paragrafit 5 të Ligjit, kostoja e asetit kapital për tatimpaguesin do të jetë:</p> <p>2.1. Nëse dëshmohet me dokumentacion, çmimi i blerjes apo ndërtimit;</p>	<p>1. For purposes of applying open market values where sales of capital assets are made between related persons for sales prices that are less than open market value, this value shall be determined as:</p> <p>1.1. The estimated monetary amount for a sale of the same asset between a willing buyer and a willing seller in an arm's-length transaction;</p> <p>1.2. The amount that would arise from the sale of a similar asset in similar circumstances (e.g. similar quality, similar size or time period and similar conditions of sale);</p> <p>1.3. Where subparagraphs 1.1., and 1.2., of this Article cannot apply, a method approved by TAK which provides a sufficiently objective approximation.</p> <p>2. For the purposes of paragraph 5 of Article 31 of The Law, the cost of capital asset for the taxpayer shall be:</p> <p>2.1. If proved by documentation, the purchase or construction price;</p>	<p>1. Za ciljeve primene otvorene vrednosti tržišta kada je prodaja kapitalne imovine obaveljena između povezanih lica i kada je manja od otvorene vrednosti tržišta, ta vrednost se određuje kao:</p> <p>1.1. Monetarni iznos predviđen za prodaju iste imovine između jednog dobrovoljnog kupca i jednog dobrovoljnog prodavca u jednoj transakciji tržišne dominacije;</p> <p>1.2. Iznos koji je rezultat prodaje jedne iste zalihe i u sličnim uslovima (na primer ima slične osobine, sličnu veličinu, ili vremenski period i iste uslove prodaje);</p> <p>1.3. Kada ne mogu da se primene podstavovi 1.1 i 1.2 ovog člana, primenjuje se metoda koja je odobrena od PAK-a, koja obezbeđuje približnu sličnost.</p> <p>2. Za potrebe člana 31. stav 5. Zakona, trošak kapitalne imovine poreskog obveznika biće takav:</p> <p>2.1. Ako se dokaže dokumentacijom, cena kupovine ili izgradnje;</p>

<p>2.2. Nëse nuk dëshmohet me dokumentacion, do të jetë 80% e vlerës së shitjes.</p> <p>3. Në rastin kur shitja e asetit kapital bëhet me marrëveshje për pagesë me këste, pagesa të cilat shtrihen në më shumë se një periudhë tatimore, fitimi kapital raportohet në baza lineare gjatë kohës së marrëveshjes me këste.</p> <p>4. Humbja kapitale raportohet në periudhën tatimore në të cilën ka ndodhur transaksioni.</p>	<p>2.2. If not proven by documentation, it will be 80% of the sales.</p> <p>3. In cases when sale of capital assets involves instalment agreements which span more than one tax period, capital gains shall be reported on a straight-line basis over the duration of the instalment arrangement</p> <p>4. Capital loss reported in the tax period in which the transaction took place.</p>	<p>2.2. Ako se dokaže dokumentacijom, biće 80% vrednosti prodaje.</p> <p>3. U slučaju kada se prodaja kapitalne imovine obavlja preko Sporazuma za isplatu na rate, isplate koje se vrše tokom više od jednog poreskog perioda, kapitalni dobitak se prijavljuje na linearnoj osnovi tokom trajanja sporazuma o ratama.</p> <p>4. Kapitalni gubitak se prijavljuje u poreskom periodu kada se desila transakcija.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 34 Shndërrimi jo i vullnetshëm</p> <p>1. Shndërrimi jo i vullnetshëm i paraparë në nenin 31, paragrafin 13 të Ligjit është tjetërsimi i pronës së paluajtshme të biznesit për nevoja publike, përmes procedurës së shpronësimit të realizuar nga autoritetet publike.</p> <p>2. Fitimi kapital nga shndërrimi jo i vullnetshëm i pronës së paluajtshme, nëse konsiderata është marrë nga shndërrimi që përbëhet nga prona e karakterit apo natyrës së njëjtë ose nga paratë që janë investuar në pronën e natyrës apo të karakterit të njëjtë brenda periudhës dy vjeçare (2) të</p>	<p style="text-align: center;">Article 34 Involuntary conversion</p> <p>1. Involuntary conversion foreseen under Article 31, paragraph 13 of the Law is the alienation of immovable property for public business, through expropriation proceedings carried out by public authorities.</p> <p>2. Capital gains from Involuntary conversion of real property, if the consideration is taken from the conversion of the property consisting of the same character or nature or from money invested in property of nature or the same character within the two (2) year period of</p>	<p style="text-align: center;">Član 34 Nedobrovoljno pretvaranje</p> <p>1. Nedobrovoljno pretvaranje predviđeno u članu 31, stav 13 Zakona je otuđenje nepokretne imovine biznisa za javne potrebe, preko procedure eksproprijacije realizovane od strane javnih organa.</p> <p>2. Kapitalni dobitak od nedobrovoljnog pretvaranja nepokretne imovine, ako se uzme u obzir da se pretvaranje sastoji iz imovine iste prirode i karaktera ili od novca koji je investiran u imovinu iste prirode i karaktera tokom dvogodišnjeg (2) perioda zamene, ne podleže Porezu na lične</p>

<p>zëvendësimit, nuk i nënshtrohet Tatimit në të Ardhurat Personale.</p> <p>3. Periudha dy (2) vjeçare sipas paragrafit 2 të këtij neni është kohëzgjatja prej njëzetekatër (24) muajve nga data e pranimit të konsideratës.</p> <p>4. Në rastin kur tatimpaguesi dështon të zëvendësojë pronën e karakterit të njëjtë brenda afatit të paraparë në paragrafin 3 të këtij neni, njohja e fitimit kapital bëhet në periudhën tatimore në të cilën skadon afati.</p> <p>5. Përjashtim nga neni 31, paragrafi 13 i Ligjit, si dhe paragrafi 2 i këtij neni, bëjnë të ardhurat e përcaktuara në nenin 8, paragrafin 1, nënparagrafin 1.20 të Ligjit. Të ardhurat e përfituara, përfshirë të ardhurat në formë monetare ose në natyrë nga personi fizik jo afarist për shpronësimet që i bëhen nga shteti për interesa publike, trajtohen të ardhura të përjashtuara.</p>	<p>replacement, shall not be subject to personal income tax.</p> <p>3. The period of two (2) years pursuant to paragraph 2 of this article shall be the duration of twenty four (24) months from the date the consideration is taken.</p> <p>4. If a taxpayer fails to replace the property of the same character within the period prescribed in paragraph 3 of this Article, recognition of capital gain shall be made in the tax period in which the term expires.</p> <p>5. Notwithstanding Article 31, paragraph 13 of the Law and paragraph 2 of this article refer to income specified in Article 8, paragraph 1, sub-paragraph 1.20 of Law. Earned income, including income in cash or in kind by a non-business natural person, for the expropriation made by the state in the public interest shall be treated as excluded income.</p>	<p>dohotke.</p> <p>3. Dvo (2) godišnji period prema stavu 2 ovog člana je trajanje od dvadeset četiri (24) meseci od dana prijema razmatranja.</p> <p>4. U slučaju kada poreski obveznik ne uspe da zameni imovinu istog karaktera tokom roka koji je predviđen u stavu 3 ovog člana, priznavanje kapitalnog dobitka radi se u poreskom periodu kada ističe rok.</p> <p>5. Izuzetak iz člana 31, stav 13 Zakona, kao i stav 2 ovog člana, čine prihodi određeni u članu 8, stav 1, podstav 1.20 Zakona. Dobijeni prihodi, uključujući i prihode u monetarnoj formi i u naturi od strane ne poslovnog fizičkog lica za eksproprijaciju obavljene od strane države za javni interes, tretiraju se kao isključeni prihodi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 35 Kërkesa për libra dhe regjistrime</p>	<p style="text-align: center;">Article 35 Requirement for Books and Records</p>	<p style="text-align: center;">Član 35 Zahtevi za knjige i evidencije</p>
<p>1. Tatimpaguesi me të ardhura vjetore bruto prej pesëdhjetëmijë euro (50,000€) ose më tepër dhe ai me të ardhura vjetore bruto më të ulëta se pesëdhjetëmijë euro (50,000€) i cili zgjedh të tatohet në bazë të të</p>	<p>1. A taxpayer with annual gross income of fifty thousand (€50,000) euro or more and the one with annual gross income of less than fifty thousand (€50,000) euro who opts to be taxed on a real income basis shall</p>	<p>1. Poreski obveznik sa godišnjim bruto prihodima u iznosu od pedeset hiljade (50,000€) evra ili više i onaj sa godišnjim bruto prihodima manjim od pedeset hiljade (50,000€) evra koji izabere da se oporezuje</p>

<p>ardhurave reale, mban librat dhe regjistrimet në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në nenin 33 të Ligjit dhe Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat.</p> <p>2. Tatimpaguesi me të ardhura vjetore bruto deri në pesëdhjetëmijë euro (50,000€) i cili nuk ka zgjedhur të tathet në bazë të të ardhurave reale, mban librat dhe regjistrimet në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në nenin 34 të Ligjit dhe Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat.</p> <p>3. Përmbajtja e librave dhe regjistrimeve të kërkuara sipas këtij Ligji, duhet të jenë në përputhje me Udhëzimin Administrativ për zbatimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat.</p>	<p>keep books and records in accordance with the requirements of Article 33 of the Law and Law on Tax Administration and Procedures.</p> <p>2. A taxpayer with annual gross income of up to fifty thousand (€50,000) euros who have not opted to be taxed on a real income basis shall keep books and records in accordance with the requirements of Article 34 of The Law and Law on Tax Administration and Procedures.</p> <p>3. The content of the books and records required under this Law, shall be in accordance with Administrative Instruction on Implementation of Law on Tax Administration and Procedures.</p>	<p>na osnovu realnih prihoda, drži knjige i evidencije u skladu sa određenim zahtevima iz člana 33 Zakona i Zakona za poresku administraciju i procedure.</p> <p>2. Poreski obveznik sa godišnjim bruto prihodima u iznosu od pedeset hiljada (50,000€) evra koji nije odabrao da se oporezuje na osnovu realnih prihoda, drži knjige i evidencije u skladu sa zahtevima određenim u članu 34 Zakona i Zakona za poresku administraciju i procedure.</p> <p>3. Sadržaj zatraženih knjiga i evidencija prema ovom Zakonu, treba da bude u skladu sa Administrativnim uputstvom za primenu Zakona za poresku administraciju i procedure.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 36 Shmangia e tatimeve të dyfishta</p> <p>1. Tatimpaguesi i cili është rezident në Kosovë dhe përfiton të ardhura nga aktivitetet afariste jashtë Kosovës, për të cilat paguan tatimin në të ardhura në shtet tjetra, i lejohet kreditimi tatimor për tatimin në të ardhura të paguar në shtetin tjetër, që i atribuohet të ardhurave të krijuara në shtetin tjetër.</p>	<p style="text-align: center;">Article 36 Avoidance of double taxation</p> <p>1. A taxpayer who is resident in Kosovo and earns income from business activities abroad, and pays income tax in other states shall be allowed tax credit for income tax paid to another state, attributable to income generated in another country.</p>	<p style="text-align: center;">Član 36 Izbegavanje dvostrukog oporezivanja</p> <p>1. Poreski obveznik koji nije rezident na Kosovu i koji dobija prihode iz poslovnih aktivnosti van Kosova, za koje plaća porez na prihode u drugim državama, dozvoljeno mu je poresko kreditiranje za porez na prihode isplaćen u drugoj državi, koji se pripisuje prihodima stvorenim u drugoj državi.</p>

<p>2. Kreditimi tatimor sipas paragrafit 1 të këtij neni, trajtohet si në vijim:</p> <p>2.1. Në rastin kur shuma e tatimit të paguar për të ardhurat e përfituara jashtë Kosovës, tejkalon shumën e tatimit obligues në Kosovë, kreditimi tatimor është i lejuar vetëm deri në shumën e tatimit obligues në Kosovë;</p> <p>2.2. Në rastin kur shuma e tatimit të paguar për të ardhurat e përfituara jashtë Kosovës, është më e ulët se shuma e tatimit obligues në Kosovë, kreditimi tatimor është i lejuar tërësisht ndërsa diferenca i nënshtrohet tatimit në Kosovë.</p> <p>3. Për personin që është rezident në vendet me të cilat Kosova ka nënshkruar Marrëveshje për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD) dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal, si dhe këto marrëveshje janë në fuqi dhe janë të zbatueshme, aplikohen dispozitat e këtyre marrëveshjeve.</p> <p>4. Me qëllim të kreditimit të tatimit të paguar jashtë vendit, tatimpaguesi rezident i ofron dëshmi ATK-së për të ardhurat e tatueshme dhe tatimin e paguar jashtë vendit, të vërtetuara nga organi tatimor i atij vendi, të cilat duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara në Kosovë.</p>	<p>2. The tax credit under paragraph 1 of this article shall be handled as follows:</p> <p>2.1. In the case where the amount of tax paid on income earned abroad, exceeds the amount of tax due in Kosovo, the tax credit is allowed only up to the amount of tax due in Kosovo;</p> <p>2.2. In the case where the amount of tax paid on income earned abroad, is lower than the amount of tax due in Kosovo, the tax credit is fully allowed and the difference is subject to tax in Kosovo.</p> <p>3. For a person who is resident in countries with which Kosovo has entered into agreements for the Elimination of Double Taxation (AEDT) and the Prevention of Fiscal Evasion, and these agreements are in force and applicable, the provisions of these agreements shall apply.</p> <p>4. For the purpose of crediting the tax paid abroad, a resident taxpayer provides evidence to TAK on taxable income and tax paid abroad, certified by the tax authority of that country, which must be translated and notarised in Kosovo.</p>	<p>2. Poresko kreditiranje iz stava 1 ovog člana, tretira se kao u nastavku:</p> <p>2.1. U slučajevima kada iznos isplaćenog poreza na prihode dobijene van Kosova, prekoračuje iznos obaveznog poreza na Kosovu, poresko kreditiranje je dozvoljeno do iznosa obaveznog iznosa na Kosovu;</p> <p>2.2. U slučaju kada je iznos plaćenog poreza za prihode dobijene van Kosova, je manji od obaveznog iznosa poreza na Kosovu, poresko kreditiranje je dozvoljeno u potpunosti dok preostala razlika podleže porezu na Kosovu.</p> <p>3. Za osobu koja je rezident u zemljama sa kojima je Kosovo potpisalo Sporazum za izbegavanje dvostrukog poreza (SIDP) i Sprečavanje utaje poreza, i ovi sporazumi su na snazi i sprovode se, primenjuju se odredbe ovih sporazuma.</p> <p>4. U cilju kreditiranja poreza plaćenog u inostranstvu, poreski obveznik rezident obezbeđuje dokaze oporezivih prihod za ATK i za porez plaćen u inostranstvu, overen od strane poreskog organa te zemlje, koji moraju biti prevedeni i overeni na Kosovu.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 37 Tatimi i mbajtur në burim në paga, pagesa dhe pensione</p>	<p style="text-align: center;">Article 37 Withholding tax on wages, remunerations and pensions</p>	<p style="text-align: center;">Član 37 Zadržavanje poreza na plate, naknade i penzije</p>
<p>1. Punëdhënësi mban në burim tatimin në pagat e tatueshme të paguara punëtorëve të tij, duke përfshirë pagesat për personat fizik jo afarist, për shërbimet profesionale, teknike, të menaxhimit, financiare, pagesat për kontratat mbi vepër, pagesat për shfaqje të aktorëve, muzikantëve, sportistëve, agjentëve të varur etj., në çdo periudhe në të cilën të ardhurat e tyre janë paguar.</p> <p>2. Punëdhënësi i cili është punëdhënësi kryesor i të punësuarit, mban në burim një shumë të tatimit për periudhën përkatëse të pagesave të pagave, në përputhje me normat e përcaktuara në nenin 6 të Ligjit.</p> <p>3. Punëdhënësi i cili nuk është punëdhënës kryesor i të punësuarit, mbanë në burim shumën prej dhjetë përqind (10%) të pagave të tatueshme për periudhën tatimore.</p> <p>4. Punëdhënësi mban tatimin në burim për pagesat e bëra sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, pasi të zbret kontributin pensional të të punësuarit dhe kontributet tjera të parapara me ligjet në fuqi, si vijon:</p>	<p>1. The employer withholds tax on taxable wages paid to its employees, including remunerations for non-business individuals, professional, technical, management, financial services, remunerations for service contracts, remunerations for performances of actors, musicians, athletes, etc. dependent agents, etc., at any period in which their incomes are paid.</p> <p>2. Employers who are an employee's principal employer shall withhold amounts of tax for payroll periods in accordance with the rates established in Article 6 of The Law</p> <p>3. An employer who is not the employee's principal employer shall withhold an amount of ten per cent (10%) of taxable wages for the tax period.</p> <p>4. The employer withholds tax at source on remunerations made under paragraph 2 and 3 of this Article, after deducting the employee's pension contribution and other contributions as provided by law in force, as follows:</p>	<p>1. Poslodavac zadržava na izvoru porez na isplaćene oporezive plate njegovih radnika, obuhvativši isplate za neposlovna fizička lica, za profesionalne usluge, tehničke, za upravljanje, finansijske, isplate ugovora za usluge, isplate za umetničke predstave, muzikante, sportiste, zavisne agente itd. za svaki period kada su njihovi prihodi isplaćeni.</p> <p>2. Poslodavac koji je glavni poslodavac zaposlenog, zadržava na izvoru jedan iznos poreza za relevantni period isplate plata, u skladu sa određenim stopama iz člana 6. Zakona.</p> <p>3. Poslodavac koji je glavni poslodavac zaposlenog, zadržava na izvoru iznos od deset posto (10%) oporezivih plata za poreski period.</p> <p>4. Poslodavac zadržava porez za isplate izvršene prema stavu 2 i 3 ovog člana, nakon odbijanja penzijskog doprinosa zaposlenog i druge doprinose predviđene zakonima na snazi, kao što sledi:</p>

<p>4.1. Punëdhënësi kryesor dhe ai sekondar kontribuon me pesë përqind (5%) mbi pagën bruto të të punësuarit.</p> <p>4.2. Punëdhënësi zbrit pesë përqind (5%) nga paga bruto e të punësuarit, dhe i paguan në emër të kontributit pensional.</p> <p>4.3 Punëdhënësi, përveç kontributit obligativ të përcaktuar në paragrafin 4, nënparagrafin 4.1 të këtij neni, mund të kontribuoj vullnetarisht edhe për një shumë plotësuese deri në dhjetë përqind (10%) mbi pagën bruto të të punësuarit.</p> <p>4.4. I punësuarit, përveç kontributit obligativ të përcaktuar në paragrafin 4, nënparagrafin 4.2 të këtij neni, mund të kontribuoj vullnetarisht edhe një shumë plotësuese deri në dhjetë përqind (10%) nga paga bruto.</p> <p>4.5. Vetëm kontributi i të punësuarit është i zbritshëm për qëllime tatimore nga paga e tij.</p> <p>4.6. Sipas paragrafit 4, nënparagrafëve 4.1 dhe 4.2 të këtij neni, Kontributi Pensional minimal pesë përqind plus pesë përqind (5%+5%), paguhet në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.</p>	<p>4.1. Primary and secondary employer contributes with five per cent (5%) on the gross salary of the employee.</p> <p>4.2. The employer deducts five per cent (5%) of the employee's gross salary, and pays the pension contribution.</p> <p>4.3. The employer, in addition to mandatory contributions specified in paragraph 4, sub-paragraph 4.1 of this Article may also voluntarily contribute an additional amount up to ten per cent (10%) on the gross salary of the employee.</p> <p>4.4. The employee, except mandatory contributions specified in paragraph 4, sub-paragraph 4.2 of this article may voluntarily contribute an additional amount up to ten per cent (10%) of gross wage.</p> <p>4.5. Only the employee contribution is deductible for tax purposes from his wage.</p> <p>4.6. Subject to paragraph 4, sub-paragraphs 4.1 and 4.2 of this article, minimum five per cent pension contribution plus five per cent (5% + 5%) shall be paid to the Kosovo Pension Savings Fund.</p>	<p>4.1. Primarni i sekundarni poslodavac doprinosi sa pet posto (5%) na bruto zarade zaposlenog.</p> <p>4.2. Poslodavac odbija pet odsto (5%) bruto zarade zaposlenog, i plaća ih za penzijski doprinos.</p> <p>4.3. Poslodavac, osim obaveznog doprinosa koji je određen u stavu 4, podstav 4.1 ovog člana, može dobrovoljno da doprinese i za jedna dopunski iznos do deset posto (10%) na bruto platu zaposlenog.</p> <p>4.4. Zaposleni, osim obaveznog doprinosa koj je određen u stavu 4, podstav 4.2 ovog člana, može dobrovoljno doprineti i jedan dodatni iznos do deset posto (10%) od bruto plate.</p> <p>4.5. Samo doprinos zaposlenog je umanjenje (odbitak) za poreske ciljeve iz njegove plate.</p> <p>4.6. Prema stavu 4, podstav 4.1 i 4.2 ovog člana, minimalan penzijski doprinos pet posto plus pet posto (5%+5%), plaća se u Fond penzijske štednje Kosova.</p>
--	--	---

<p>4.7. Sipas paragrafit 4, nënparagrafëve 4.3 dhe 4.4 të këtij neni, kontributet plotësuese pensionale, mund të paguhen në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës apo në ndonjë fond tjetër të licencuar nga BQK.</p> <p>5. Pensionet e paguara nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës apo nga një fond i autorizuar plotësues i pensioneve, i rregulluar me legjislacionin mbi kontributet pensionale, i nënshtrohet mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i pensioneve të tilla sipas shkallëve të parapara në nenin 6 të Ligjit.</p> <p>5.1. Vlera e pensioneve të kursyera të cilat tërhiqen nga përfituesi si shuma të tërësishme, tatóhen sipas shkallëve vjetore, siç janë paraparë në nenin 6 të Ligjit.</p> <p>5.2. Shumat e tërësishme që përfiton trashëguesi pas vdekjes së përfituesit i cili nuk ka arritur ende moshën e pensionimit, tatóhet sipas shkallëve vjetore siç janë paraparë në nenin 6 të Ligjit.</p> <p>5.3. Vlera e pensioneve të kursyera të cilat tërhiqen nga përfituesi në faza të shprehur në përqindje sipas bilancit të llogarisë, propozuar nga Fondi apo Ofruesi i pensioneve, tatóhet sipas</p>	<p>4.7. Subject to paragraph 4, subparagraphs 4.3 and 4.4 of this Article, additional pension contributions may be paid to the Kosovo Pension Savings Fund or any other Fund licensed by CBK.</p> <p>5. Pensions paid by the Fund Kosovo Pension Savings Fund or from an authorized supplementary pension fund regulated by the law on pension contributions shall be subject to the withholding tax at source by the payer of such pensions as tfor rates provided for in Article 6 Law.</p> <p>5.1. The value of pension savings withdrawn by the beneficiary as the total amount, are taxed according to annual rates, as provided in Article 6 of the Law.</p> <p>5.2. The total amount benefited by the inheritor after the death of the beneficiary who has not yet reached retirement age, shall be taxable according to the annual rates as provided in Article 6 of the Law.</p> <p>5.3. The value of pension savings withdrawn by the beneficiary in phases, in percentage according to account balance, proposed by the Fund or pension provider shall be taxed</p>	<p>4.7. Prema stavu 4, podstav 4.3 i 4.4 ovog člana, dopusni penzijski doprinosi, mogu se platiti u Fond penzijske štednje Kosova ili neki drugi fond licenciran od strane CBK.</p> <p>5. Penzije isplaćene od Fonda penzijske štednje Kosova ili neki drugi dopunski ovlašćeni fond penzija, regulisani zakonodavstvom o penzijskim doprinosima, podleže porezu po odbitku od strane isplatioca penzija prema stepenu predviđenom u članu 6 Zakona.</p> <p>5.1. Vrednost penzijske štednje koja će biti povučena od strane korisnika kao ukupan iznos, oporezuje se prema godišnjoj stopi, kao što je predviđeno u članu 6 Zakona.</p> <p>5.2. Ukupan iznos koji dobija naslednik nakon smrti korisnika koji još nije dostigao starost za penziju, oporezuje se prema godišnjoj stopi kao što je predviđeno u članu 6 Zakona.</p> <p>5.3. Vrednost ušteđenih penzija koje će biti povučene od korisnika u fazama izraženo u procentima prema obračunatom bilansu, predloženo od Fonda ili od Davaoca penzija, oporezuju</p>
---	--	--

<p>shkallëve mujore, siç janë paraparë në nenin 6 të Ligjit.</p> <p>6. Sigurimet shëndetësore vullnetare të paguara nga punëdhënësi për të punësuarit, vazhdojnë të trajtohen si të ardhura të të punësuarit dhe i nënshtrohen tatimit të mbajtur në burim deri në fillimin e zbatimit të Ligjit për Sigurimet Shëndetësore obligative.</p> <p style="text-align: center;">Neni 38 Tatimi i mbajtur në burim në interes dhe të drejtat pronësore</p> <p>1. Sipas nenit 39, paragrafit 1 të Ligjit, tatimpaguesit që paguajnë interes për kreditë e marra duke përfshirë huazimet (me përjashtim të rasteve të përcaktuara në nenin 39, paragrafin 2 të Ligjit), apo të drejta pronësore të përcaktuara në nenin 18, paragrafin 1, nënparagrafin 1.2, të këtij Udhëzimi Administrativ, për personat rezidentë dhe jo rezidentë, mbajnë tatimin në burim në shkallën dhjetë përqind (10%) në kohën e pagesës apo kreditimit në llogarinë e përfituesit. Tatimi i mbajtur në burim paguhet në bankë, apo institucion financiar deri në ditën e 15-të të muajit që pason muajin në të cilin llogaria është kredituar apo pagesa është bërë.</p>	<p>according to monthly rates, as provided in Article 6 of the Law.</p> <p>6. Voluntary health insurance paid by the employer to the employees continue to be treated as income of the employee and subject to withholding tax until the Law on Mandatory Health Insurance commences with implementation.</p> <p style="text-align: center;">Article 38 Withholding tax on interest and royalties</p> <p>1. Pursuant to Article 39, paragraph 1 of the Law, taxpayers who pay interest on loans taken including borrowings (except cases specified in Article 39, paragraph 2 of the Law), or royalties defined in Article 18, paragraph 1, sub-paragraph 1.2 of this Administrative Instruction for the residents and non-residents shall withhold tax at the rate of ten per cent (10%) at the time of payment or credit to the account of the beneficiary. Withholding tax shall be paid in the bank, or financial institution by the 15th day of the month following the month in which the account is credited or the payment made.</p>	<p>se prema mesečnoj stopi kao što je predviđeno u članu 6 Zakona.</p> <p>6. Dobrovoljno zdravstveno osiguranje isplaćeno od poslodavca za zaposlenog, i dalje se tretira kao prihod za zaposlenog i podleže zadržanom porezu do početka sprovođenja Zakona o obaveznim zdravstvenim osiguranjima.</p> <p style="text-align: center;">Član 38 Porez po odbitku na kamate i vlasnička prava</p> <p>1. Prema členu 39, stav 1 Zakona, poreski obveznici koji plaćaju dobijene kredite obuhvativši pozajmice (sa izuzetkom slučajeva određenih u članu 39, stav 2 Zakona), ili imovinska prava određena u članu 18, stav 1, podstav 1.2, ovog Administrativnog uputstva, za rezidentna i nerezidentna lica, zadržavaju porez po odbitku u stopi od deset posto (10%) u vreme isplate ili kreditiranja na računu korisnika. Odbijeni porez plaća se u banci, ili finansijskoj instituciji do 15-tog dana narednog meseca nakon meseca kada je kreditiran račun ili kada je izvršena isplata.</p>
---	--	--

<p>2. Interesi apo të drejtat pronësore të paguara apo të kredituara personit i cili është i liruar nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave sipas nenit 7 të Ligjit nr. 05/L-029, si dhe nenit 8 të Ligjit ose sipas një marrëveshje ndërshtetërore, nuk i nënshtrohet tatimit në burim. Në këtë rast, barra bie mbi pranuesin e interesit dhe të drejtave pronësore që t'i sigurojë evidencë me shkrim paguesit se të ardhurat e tij janë të lira nga tatimi.</p> <p>3. Neni 39, paragrafi 2 i Ligjit, përcakton që interesi për kreditë e dhëna nga institucionet e licencuara nga BQK për klientët e tyre në kursin e zakonshëm të biznesit të tyre dhe interesi në instrumentet financiare të lëshuara ose të garantuara nga Autoriteti Publik i Kosovës, nuk i nënshtrohet mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i interesit.</p> <p>4. Lirimi i paraparë në paragrafin 3 të këtij neni nuk aplikohet për interesin e paguar në kreditë nga institucionet financiare jo-rezidente. Në këto raste paguesi i interesit mban tatimin në burim nga pagesat e tyre të interesit për institucionet financiare jo rezidente.</p>	<p>2. Interest or royalties paid or credited to a person who is exempted from income tax under Article 7 of the Law no. 05 / L-029 on Corporations and Article 8 of the law or under an interstate agreement, shall not subject to withholding tax. In this case, the onus is on the recipient of the interest and royalties to provide written evidence to the payer that their income is exempted from tax.</p> <p>3. Article 39, paragraph 2 of the Law foresees that interest on loans provided by institutions licensed by CBK to their customers in the ordinary course of their business and interest in financial instruments issued or guaranteed by the Public Authority of Kosovo shall not subject to the withholding at source by the payer of interest.</p> <p>4. The exemption provided for in paragraph 3 of this Article shall not apply to interest paid on loans from non-resident financial institutions. In these cases, the interest payer withholds tax at source from their interest payments to non-resident financial institutions.</p>	<p>2. Kamata ili imovinska prava isplaćena ili kreditirana osobi koja je oslobođena od Poreza na prihod korporacija prema članu 7 Zakona br. 05/L-029, kao i člana 8 Zakona ili prema nekom međudržavnom sporazumu, ne podležu porezu po odbitku. U ovom slučaju, teret pada na primaoca kamate i imovinskih prava da obezbedi pismene evidencije isplatiocu da su njegovi prihodi oslobođeni poreza.</p> <p>3. Član 39, stav 2 Zakona, određuje da kamata za kredite koje daju licencirane institucije CBK za njihove kliente u redovnom toku njihovog poslovanja i kamate na finansijske instrumente izdate ili garantovane od Kosovske javne vlasti, ne podležu zadržavanju na izvoru od strane isplatioca kamate.</p> <p>4. Oslobođanje predviđeno u stavu 3 ovog člana ne primenjuje se za isplaćenu kamatu za kredite ne – rezidentnih finansijskih institucija. U ovim slučajevima isplatioc kamate zadržava na izvoru od njihovih isplata kamate za ne – rezidentne finansijske institucije.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 39 Tatimi i mbajtur në burim në qira</p>	<p style="text-align: center;">Article 39 Lease withholding tax</p>	<p style="text-align: center;">Član 39 Porez po odbitku za zakupnine</p>
<p>1. Qiramarrësi mban në burim tatimin në pagesën e qirasë, në përputhje me nenin 39, paragrafin 4 të Ligjit.</p> <p>1.1. Qiraja e paguar ose e kredituar në llogarinë e përfituesit i cili është i liruar nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave sipas nenit 7 të Ligjit Nr.05/L-029 ose sipas një marrëveshje ndërshtetërore, nuk i nënshtrohet tatimit në burim. Në këtë rast, barra bie mbi pranuesin e qirasë të sigurojë evidencë me shkrim për paguesin se të ardhurat e tij janë të liruara nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave.</p> <p>1.2. Evidenca me shkrim e kërkuar sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë:</p> <p>1.2.1. Në rast se organizata është e liruar nga Tatimi në të Ardhurat në Korporata sipas nenit 7, paragrafit 1, nënparagrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-029, një kopje e certifikatës së regjistrimit të organizatës jo-qeveritare;</p> <p>1.2.2. Në rast të organizatave të liruara nga Tatimi në të Ardhurat në</p>	<p>1. The Lessee withholds tax on paying the lease, in accordance with Article 39, paragraph 4 of Law.</p> <p>1.1. the lease paid or credited to the account of the beneficiary who is exempted from income tax under Article 7 of the Law No.05/L-029 on Corporations or under an interstate agreement shall not subject to withholding tax. In this case, the onus is on the recipient of the lease to provide written evidence to the payer that their income is exempted from tax in the Corporate Income.</p> <p>1.2. The written evidence required under paragraph 1 of this Article shall contain:</p> <p>1.2.1. If the organization is exempted from income tax on corporations under Article 7, paragraph 1, subparagraph 1.1 of the Law No.05 / L-029, a copy of the certificate of registration of non-governmental organization;</p> <p>1.2.2. In the case organizations are exempted from income tax on</p>	<p>1. Zakupnik zadržava (odbija) porez za isplatu zakupa, prema članu 39, stav 4 Zakona.</p> <p>1.1. Isplaćeni ili kreditirani zakup na računu korisnika koji je oslobođen od Poreza na prihode korporacija prema članu 7 Zakona br. 05/L-029 ili prema nekom međudržavnom ugovoru, ne podleže porezu po odbitku. U ovom slučaju dužnost je primaoca zakupa da obezbedi pismene evidencije za isplatioca da su njegovi prihodi oslobođeni od Poreza na prihode korporacija.</p> <p>1.2. Pismena evidencija zatražena prema stavu 1 ovog člana treba da sadrži:</p> <p>1.2.1. Ako je organizacija oslobođena od Poreza na prihod korporacija na osnovu člana 7 stav 1 podstav 1.1 Zakona br.05 / L-029, kopija certifikata (potvrde) o registraciji nevladine organizacije</p> <p>1.2.2. U slučaju organizacija oslobođenih od Poreza na prihod korporacija na osnovu člana 7, stav 1,</p>

<p>Korporata sipas nenit 7, paragrafit 1, nënparagrafëve 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-029, një kopje të noterizuar të kontratës;</p> <p>1.2.3. Në rast të institucioneve financiare qeveritare ndërkombëtare të cilat janë përmendur në mënyrë të veçantë në nenin 7, paragrafin 1, nënparagrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.05/L-029, një kopje e autorizimit për ushtrimin e veprimtarisë së tyre në Kosovë;</p> <p>1.2.4. Në rast të organizatave të huaja qeveritare dhe diplomatike, një kopje e autorizimit për ushtrimin e veprimtarisë së tyre në Kosovë;</p> <p>2. Kontraktori primar dhe nënkontraktori i përkufizuar në paragrafin 1.10 dhe 1.11 të nenit 8 të Ligjit, mban tatimin në burim në qira.</p> <p>3. Personi fizik jo afarist nuk mban tatimin në burim për pagesat e qirasë.</p> <p>4. Tatimpaguesi i cili i paguan qira autoritetit publik, qendror apo lokal, nuk mban tatimin në burim për pagesat e bëra.</p> <p>5. Tatimpaguesi i cili i paguan qira Bashkësisë Fetare, mban tatimin në burim</p>	<p>corporations under Article 7, paragraph 1, sub-paragraphs 1.5 and 1.6 of the Law No.05/ L-029, a notarised copy of the contract;</p> <p>1.2.3. In the case of international governmental financial institutions specifically mentioned in Article 7, paragraph 1, sub-paragraphs 1.1 and 1.2 of the Law No.05/L-029, a copy of the authorization to exercise their activity in Kosovo;</p> <p>1.2.4. In case of foreign governmental and diplomatic organizations, a copy of the authorization to exercise their activity in Kosovo;</p> <p>2. The primary contractor and subcontractor as defined in paragraph 1.10 and 1.11 of Article 8 of the Law shall withhold lease tax.</p> <p>3. A non-business natural person shall not withhold source tax on lease payments.</p> <p>4. A taxpayer who pays lease to public authority, central or local, shall withhold source tax on payments made.</p> <p>5. A taxpayer who pays lease to Religious Community shall withhold source tax on</p>	<p>podstav 1.5 i 1.6 Zakona br. 05 / L-029, jednu overenu kopiju ugovora;</p> <p>1.2.3. U slučaju međunarodnih vladinih finansijskih institucija koje su izričito navedene u članu 7. stav 1, podstav 1.1 i 1.2 Zakona br. 05 / L-029, jednu kopiju ovlašćenja za obavljanje njihove aktivnosti na Kosovu.</p> <p>1.2.4. U slučaju stranih vladinih i diplomatskih organizacija, jednu kopiju ovlašćenja za obavljanje njihove delatnosti na Kosovu;</p> <p>2. Primarni ugovarač i pod – ugovarač kao što je definisano u stavu 1.10 i 1.11 člana 8. Zakona, primenjuje porez po odbitku na zakupninu.</p> <p>3. Neposlovno fizičko lice ne zadržava porez na izvoru za isplatu zakupnine.</p> <p>4. Poreski obveznik koji plaća zakupninu javnim autoritetima, centralnim ili lokalnim, zadržava porez po odbitku za izvršene isplate.</p> <p>5. Poreski obveznik koji plaća zakupninu Verskoj zajednici, zadržava porez na izvoru</p>
--	--	---

<p>për pagesat e bëra.</p> <p>6. Tatimpaguesi dorëzon formularin e deklarimit dhe pagesës (pasqyrën e tatimit të mbajtur në burim në qira) dhe informacionet e nevojshme, në formën e përcaktuar nga ATK.</p> <p style="text-align: center;">Neni 40 Mbajtja e tatimit në burim për kategori të veçanta</p> <p>1. Sipas nenit 40, paragrafit 1 të Ligjit, çdo person fizik afarist që bënë pagesa për personat fizik jo-afarist, - bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve recikluese, frutave të malit, bimëve mjekuese dhe të ngjashme me to, në momentin e pagesës mban tatimin në burim në shkallën prej tre përqind (3%) në bruto pagesë.</p> <p>2. Personi fizik afarist, i cili mban tatimin në burim sipas paragrafit 1 të këtij neni, dorëzon Pasqyrën e tatimit të mbajtur në burim dhe e transferon shumën në llogarinë e caktuar nga ATK, në një bankë apo institucion financiar, të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik.</p> <p>3. Personi fizik afarist i cili mban tatimin në burim sipas dispozitave të Ligjit, deri</p>	<p>payments made.</p> <p>6. A taxpayer submits the declaration and payment form (statement of source withholding tax on lease) and necessary information, in the form prescribed by TAK.</p> <p style="text-align: center;">Article 40 Withholding tax at source for specific categories</p> <p>1. Pursuant to Article 40, paragraph 1 of the law, any business person who makes payments to non-business individuals, - farmers, collectors of recyclable materials, berries, herbs and similar, at the moment of payment shall withhold source tax at the rate of three per cent (3%) in gross pay.</p> <p>2. A natural business person who withholds source tax under paragraph 1 of this Article shall submit a statement of withholding source tax and transfer the amount to the account designated by TAK in a bank or financial institution, licensed by the Central Bank Kosovo, within fifteen (15) days after the last day of each calendar month.</p> <p>3. A natural business person who withholds source tax under the provisions of the Law,</p>	<p>za izvršene isplate.</p> <p>6. Poreski obveznik podnosi obrazac deklaracije i uplatnicu (izjava poreza po odbitku na iznajmljivanje) i neophodne informacije, u formi propisanoj od strane PAK.</p> <p style="text-align: center;">Član 40 Porez po odbitku za posebne kategorije</p> <p>1. U skladu sa članom 40. stav 1. Zakona, bilo koje poslovno lice koje vrši isplate za ne poslovna fizika lica, - poljoprivrednici, farmeri, sakupljači sekundarnih sirovina, šumskog voća, lekovitog bilja i slično, u trenutku plaćanje zadržava porez na izvoru po stopi od tri posto (3%) u bruto isplati.</p> <p>2. Poslovno fiziko lice, koji zadržava porez po odbitku prema stavu 1 ovog člana, podnosi izveštaj o zadržavanju poreza na izvoru i doznačava iznos na računu koji je određen od strane PAK u banci ili finansijskoj instituciji, licenciran od strane Centralne banke Kosova u roku od petnaest (15) dana nakon poslednjeg dana svakog kalendarskog meseca.</p> <p>3. Poslovno fizičko lice koji drži porez po odbitku prema odredbama Zakona, do 31</p>
--	---	---

<p>më 31 Mars të vitit pasues dorëzon Raportin përmbledhës vjetor, me informacionet e nevojshme për personat të cilëve iu është mbajtur tatimi në burim. Në raport përfshihet:</p> <p>3.1. Periudha tatimore;</p> <p>3.2. Emri i biznesit i cili ka mbajtur tatimin në burim;</p> <p>3.3. Numri Fiskal i biznesit;</p> <p>3.4. Emri dhe mbiemri i personit fizik jo-afarist;</p> <p>3.5. Numri identifikues i personit fizik jo-afarist;</p> <p>3.6. Shuma e paguar;</p> <p>3.7. Tatimi i mbajtur në burim.</p> <p>4. Personi fizik afarist i cili mban tatimin në burim, deri më 1 mars të vitit pasues të periudhës tatimore, me kërkesën e personit fizik jo afarist të cilit i është mbajtur tatimi në burim, i siguron certifikatën e tatimit të mbajtur në burim, në formën e specifikuar nga ATK.</p>	<p>until 31st of March of the following year shall submit an annual summary report, with the required information for people whom source tax was withheld. The report shall include:</p> <p>3.1. The tax period;</p> <p>3.2. Business name withholding taxes at source;</p> <p>3.3. Business Fiscal Number;</p> <p>3.4. Name and surname of the natural non-business person;</p> <p>3.5. Identification number of non-business natural person;</p> <p>3.6. The amount paid;</p> <p>3.7. Source Withholding tax.</p> <p>4. A natural business person who withholds source tax, until March 1 of the year following the tax period at the request of a natural non-business person, whose tax is withheld at source, provides a certificate of tax deducted at source form specified by TAK.</p>	<p>marta naredne godine dostavlja Sažeti godišnji izveštaj, sa neophodnim informacijama za lica kojima je zadržan porez po odbitku:</p> <p>3.1. U izveštaju su obuhvaćeni;</p> <p>3.2. Ime biznisa koji je zadržao porez na izvoru;</p> <p>3.3. Fiskalni broj biznisa;</p> <p>3.4. Ime i prezime ne – poslovnog fizičkog lica;</p> <p>3.5. Broj identifikacije ne – poslovnog fizičkog lica;</p> <p>3.6. Isplaćeni iznos;</p> <p>3.7. Zadržani porez na izvoru.</p> <p>4. Poslovno fizičko lice koje zadržava porez na izvoru, do 1 marta sledeće godine poreskog perioda, na zahtev ne – poslovnog fizičkog lica kome je zadržan porez po odbitku, obezbeđuje Uvernje poreza zadržanog na izvoru, u formi koja je specifikovana od PAK.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 41 Mbajtja e tatimit në burim në pagesa të caktuara për jo-rezidentët</p>	<p style="text-align: center;">Article 41 Withholding tax at source on certain payments to non-residents</p>	<p style="text-align: center;">Član 41 Porez po odbitku za određene isplate za ne - rezidente</p>
<p>1. Sipas nenit 41, paragrafit 1 të Ligjit, të ardhurat që i atribuohen një jo-rezidenti për shërbimet e ofruara fizikisht në Kosovë, si një zbavitës, sikurse është teatri, figurat e lëvizshme, artistë, këngëtar apo muzikant, ose si një sportist, nga aktivitetet e tij apo saj, i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i të ardhurave, qoftë të paguara drejtpërdrejtë apo tërthorazi personit jo rezident.</p> <p>2. Të ardhurat e përcaktuara sipas nenit 41, paragrafit 2 të Ligjit, të realizuara nga marrëveshjet apo kontratat, qofshin me shkrim apo me gojë, me personat apo entitetet e Kosovës, nga një person apo entitet jo-rezident, për shërbimet e kryera fizikisht në Kosovë, i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i të ardhurave, përderisa personi apo entiteti jo-rezident nuk ka njësi të përhershme në Kosovë.</p> <p>3. Përjashtim nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni bëjnë të ardhurat e realizuara nga personi jo-rezident, i cili trajtohet i punësuar në Kosovë. Të ardhurat e tilla tatimohen sipas nenit 38 të Ligjit.</p>	<p>1. Pursuant to Article 41, paragraph 1 of the Law, the income attributable to a non-resident for services rendered physically in Kosovo, as an entertainer, such as a theatre, motion picture, artists, singer or musician, or as a sportsman from his or her activities, subject to the withholding at source by the payer of income, whether paid directly or indirectly to non-resident.</p> <p>2. Income defined under article 41, paragraph 2 of the Law, earned from agreements or contracts, whether in written or verbal, with Kosovo persons or entities by a non-resident person or entity for services rendered physically in Kosovo, subject to the withholding tax at source by the payer of income, unless the non-resident person or entity has no permanent establishment in Kosovo.</p> <p>3. Notwithstanding paragraphs 1 and 2 of this article, are incomes earned by non-resident person, who is treated as employed in Kosovo. Such income is taxed under Article 38 of the Law.</p>	<p>1. Prema članu 41, stav 1 Zakona, prihodi koji se pripisuju nekom nerezidentu za usluge pružene fizički na Kosovu, kao neki zabavljač, kao što je pozorište, pokretne figure, umetnik, pevač ili muzikant, ili neki sportista, od njegovih ili njenih aktivnosti, predmet su Poreza zadržanog na izvoru od isplatioca prihoda, bilo da su direktno ili indirektno isplaćene nerezidentnom licu.</p> <p>2. Prihodi određeni prema članu 41, stav 2 Zakona, realizovane putem sporazuma ili ugovora, bilo pismeno ili usmeno, sa osobama ili entitetima na Kosovu, od strane nekog lica ili entiteta nerezidenta, za fizički pružene usluge na Kosovu, podležu porezu po odbitku od isplatioca prihoda, dok nerezidentno lice ili entitet nema stalnu jedinicu na Kosovu.</p> <p>3. Izuzetak iz stava 1 i 2 ovog člana tiče se prihoda relaizovanih od strane nerezidentnog lica, koji se smatra kao zaposleni na Kosovu. Takvi prihodi oporezuju se prema članu 38 Zakona.</p>

<p>4. Të ardhurat e përcaktuara sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, kur i paguhen personit jo rezident ose entitetit, i cili është i liruar nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave sipas një marrëveshje ndërshtetërore, nuk i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim. Në këtë rast barra bie mbi pranuesin e të ardhurave që të siguroj evidencë me shkrim për pagesin se të ardhurat e tij janë të lira nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave. Deri në sigurimin e evidencës, obligimi i mbetet pagesit që të mbajë tatimin në burim.</p> <p>5. Në rastet kur pagesat e kryera për jo rezidentët për shërbimet e kryera pjesërisht në Kosovë dhe pjesërisht jashtë saj, vetëm për pjesën e shërbimit të kryer fizikisht në Kosovë kërkohet mbajtja e tatimit në burim.</p> <p>6. Përjashtim nga paragrafi 5 i këtij neni, nëse përqindja e pjesëmarrjes së shërbimit të kryer në Kosovë nuk tejkalon dhjetë përqind (10%) të shumës së përgjithshme të shërbimit, nuk i nënshtrohet mbajtjes së tatimit në burim.</p>	<p>4. Income defined under paragraphs 1 and 2 of this article, when paid to non-resident person or entity, which is exempted from tax on corporate incomes under an interstate agreement, not subject to withholding the tax at source. In this case, the onus is on the recipient's income to provide written evidence to the payer that their income is exempted from tax in the Corporate Income. By providing evidence, the obligation remains to the payer to withhold source tax.</p> <p>5. In cases where payments made to non-residents for services rendered partly in and partly outside Kosovo, withholding tax at source shall be required only for the service rendered physically in Kosovo.</p> <p>6. Notwithstanding paragraph 5 of this Article, if the percentage of services performed in Kosovo shall not exceed ten per cent (10%) of the total amount of service, it shall not be subject to the withholding tax at source.</p>	<p>4. Prihodi određeni prema stavu 1 i 2 ovog člana, kada se plaćaju nerezidentnom licu ili entitetu, koji je oslobođen Porezu na prihode korporacija prema nekom međudržavnom sporazumu, ne podleže porezu po odbitku. U ovom slučaju obaveza je na primaocu prihoda da obezbedi pismenu evidenciju za isplatioca da su njegovi prihodi oslobođeni od Poreza na prihode korporacija. Do obezbeđenja evidencije, obaveza ostaje isplatiocu da zadrži porez na izvoru.</p> <p>5. U slučajevima kada se vrši isplata nerezidentima za pružene usluge delimično u Kosovu, a delom van Kosova, samo za pružene usluge fizički na Kosovu potreban je porez po odbitku.</p> <p>6. Izuzetak iz stave 5 ovog člana, ako procenat učešća izvršene usluge na Kosovu ne prekoračuje deset posto (10%) ukupnog iznosa usluge, ne podleže porezu po odbitku.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 42 Dispozitat e përgjithshme që aplikohen për tatimet e mbajtura në burim</p>	<p style="text-align: center;">Article 42 General provisions which apply to source withheld taxes</p>	<p style="text-align: center;">Član 42 Opšte odredbe koje se primenjuju za porez po odbitku</p>
<p>1. Tatimpaguesi i cili është i obliguar të mbaj tatimin në burim, dorëzon pasqyrën e mbajtjes së tatimit në burim dhe transferon shumën në një llogari të caktuar nga ATK, në njërën nga bankat apo institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik.</p> <p>2. Në rastin kur data specifike e deklarimit apo pagesës nuk është ditë pune, këto forma dhe/ose pagesa dorëzohen më së voni në ditën e parë të punës që pason pas asaj dite.</p> <p>3. Tatimpaguesi i cili mban tatimin në burim sipas Kapitullit IX të Ligjit, gjatë një periudhe tatimore, me kërkesë të pranuesit të të ardhurave, është i obliguar të pajis të njëjtin me certifikatën e tatimit të mbajtur në burim, në formën e specifikuar nga ATK.</p> <p>4. Tatimpaguesi i cili mban tatimin në burim sipas Kapitullit IX të Ligjit, gjatë një periudhe tatimore, është i obliguar të dorëzojë në ATK informacionet e nevojshme për personat të cilëve u është</p>	<p>1. A taxpayer, who is required to withhold tax at source, shall submit a statement of withholding source tax and transfer the amount in an account designated by TAK, in one of the banks or financial institutions licensed by the Central Bank of Kosovo within fifteen (15) days after the last day of each calendar month.</p> <p>2. When the specific date of declaration or payment is not a working day, these forms and/or payment is submitted at the latest on the first working day following the day.</p> <p>3. A taxpayer who withholds tax at source pursuant to Chapter IX of the Law, during a tax period, under the request of the recipient of the income is required to provide the same with a certificate of source withholding tax in the form specified by TAK.</p> <p>4. A taxpayer who withholds tax at source pursuant to Chapter IX of the Act, during a tax period shall be obliged to submit required information to TAK for persons who have been paid and taxes withheld, in</p>	<p>1. Poreski obveznik je dužan da zadrži porez na izvoru, dostavlja izveštaj o porezu po odbitku i prenosi iznos na nekom računu određenom od PAK, u neku od banaka ili finansijskih institucija licencirane od Centralne banke Kosova, tokom petnaest (15) dana nakon poslednjeg dana svakog kalendarskog meseca.</p> <p>2. U slučaju kada specifični datum izjave ili isplate nije radni dan, ove forme i/ili isplate dostavljaju se najkasnije prvog narednog radnog dana koji sledi nakon tog dana.</p> <p>3. Poreski obveznik koji zadržava porez na izvoru prema poglavlju IX Zakona, tokom jednog poreskog perioda na zahtev primaoca prihoda, dužan je da ga opremi certifikatom poreza po odbitku, na način koji je specifikovan od strane PAK.</p> <p>4. Poreski obveznik koji zadržava porez na izvoru prema poglavlju IX Zakona, tokom jednog poreskog perioda, dužan je da dostavi PAK potrebne informacije za osobe kojima je isplaćen i zadržan porez na</p>

<p>paguar dhe mbajtur tatimi në burim, në formën e përcaktuar nga ATK.</p> <p style="text-align: center;">Neni 43 Ortakëritë dhe grupimi i personave</p> <p>1. Neni 42, paragrafi 3, i Ligjit, përcakton se ortakët apo anëtarët e grupit dorëzojnë pagesa tremujore paradhënie sipas nenit 43, paragrafit 2, nën paragrafi 2.2 të Ligjit dhe paguajnë shumën obligative për të ardhurat nga ortakëria apo grupimi i personave, varësisht nga përqindja e pjesëmarrjes në ortakëri apo grupim të personave, duke i përfshirë edhe të ardhurat tjera nëse ortaku apo anëtari realizojnë jashtë ortakërisë apo grupimit.</p> <p>2. Në rast se gjatë periudhës tatimore, ortakëria apo grupimi i personave rezultojnë me humbje, humbja nuk shpërndahet tek ortakët apo anëtarët e grupit, por mbetet humbje e ortakërisë apo grupimit të personave dhe trajtohet në përputhje me nenin 26 të Ligjit.</p> <p>3. Përjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni bëjnë rastet kur ortaku tërhiqet nga ortakëria apo shpërbëhet ortakëria. Në këto raste, ortaku ose ortakët bartin humbjen e krijuar në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në ortakëri.</p>	<p>the form prescribed by TAK.</p> <p style="text-align: center;">Article 43 The partnership and grouping of persons</p> <p>1. Article 42, paragraph 3, of the Law foresees that the partners or members of the group submit quarterly advance payments pursuant to Article 43, paragraph 2, subparagraph 2.2 of the Law and pay the amount due to the income from the partnership or grouping of persons, depending on the percentage of share in the partnership or group of persons, including other income if the partner or member of the partnership or grouping earns.</p> <p>2. If during the tax period, partnership or group of persons result in the loss, the loss is allocated to the partners or members of the group, but remains a loss of the partnership or grouping of persons and shall be handled in accordance with Article 26 of the Law.</p> <p>3. Notwithstanding paragraph 2 of this article refers to when a partner withdraws from the partnership or the partnership dissolves. In these cases, the partner or partners bear the loss generated in proportion to their shares in the partnership.</p>	<p>izvoru, na način određen od strane PAK.</p> <p style="text-align: center;">Član 43 Partnerstvo i grupacije lica</p> <p>1. Član 42, stav 3, Zakona, određuje da partnerstvo ili članovi grupacije dostavljaju tromesečne isplate kao avans prema članu 43, stav 2, podstav 2.2 Zakona i plaćaju obavezan iznos za prihode od partnerstva ili grupacije lica, zavisno od procenta učešća u partnerstvu ili grupacije lica, uključujući i druge prihode ako ih partner ili član realizuje van partnerstva ili grupacije.</p> <p>2. U slučaju da tokom poreskog perioda, partnerstvo ili grupacija lica pokazuje gubitke, gubitak se ne deli na planove partnerstva ili grupacije, već ostaje kao gubitak partnerstva ili grupacije lica i tretira se u skladu sa članom 26 Zakona.</p> <p>3. Izuzetak iz stava 2 ovog člana predstavljaju slučajevi kada se partner povuče iz partnerstva ili kada se raspada partnerstvo. U ovim slučajevima, partner ili partneri prenose stvoreni gubitak proporcionalno sa njihovim učešćem u partnerstvu.</p>
---	--	--

<p>4. Ortakëritë dhe grupimi i personave, si dhe ortakët e ortakërive dhe anëtarët e grupeve, mbajnë libra dhe regjistrime në përputhje me nenin 33, paragrafin 5 të Ligjit dhe secili ortak paguan tatimet në të ardhura obligative në përputhje me nenin 43, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 të Ligjit.</p>	<p>4. Partnerships and grouping of persons and partners of partnerships and members of groups, shall maintain books and records in accordance with Article 33, paragraph 5 of the Law and each partner pays income taxes due in accordance with Article 43, paragraph 2, subparagraph 2.2 of the Law.</p>	<p>4. Partnerstvo ili grupacija lica, kao i partneri partnerstva i članovi grupacija, drže knjige i evidencije u skladu članom 33, stav 5 Zakona i svaki partner plaća porez na obavezne prihode u skladu sa članom 43, stav 2, podstav 2.2 Zakona.</p>
<p>5. Nëse ortakët apo anëtarët e grupit, përveç të ardhurave nga ortakëria apo grupimi i personave, realizojnë edhe të ardhura tjera jashtë ortakërisë apo grupimit të personave, obligohen të mbajnë libra dhe regjistrime në përputhje me nenin 33, paragrafin 5 të Ligjit.</p>	<p>5. If the partners or members of the group, except for income from the partnership or grouping of persons, also earn other income outside the partnership or group of persons shall be required to maintain books and records in accordance with Article 33, paragraph 5 of the Law.</p>	<p>5. Ako partneri ili članovi grupacije, osim prihoda od partnerstva ili grupacije lica, realizuju i druge prihode van partnerstva ili grupacije lica, dužni su da drže knjige i evidencije prema članu 33, stav 5 Zakona.</p>
<p>6. Ortakët apo anëtarët e grupit deklarojnë dhe paguajnë në përputhje me nenin 43, paragrafin 2, nënparagrafin 2.2 të Ligjit, duke përfshirë edhe të ardhurat tjera jashtë ortakërisë apo grupimit të personave.</p>	<p>6. The partners or members of the group declare and pay in accordance with Article 43, paragraph 2, subparagraph 2.2 of the Law, including other income outside the partnership or group of persons.</p>	<p>6. Partneri ili članovi grupacije lica izjavljuju i plaćaju u skladu sa članom 43, stav 2, podstav 2.2 Zakona, obuhvativši i druge prihode van partnerstva ili grupacije lica.</p>
<p>7. Ortakëria dhe grupimi i personave janë përgjegjës për të deklaruar dhe paguar të gjitha llojet e tatimeve, përfshirë kontributet për të punësuarit, përveç tatimit në të ardhura të ortakërisë dhe grupimit të personave, deklarimin e të cilit e bënë ortakëria apo grupimi i personave ndërsa pagesën e bëjnë ortakët apo anëtarët e grupit, varësisht nga statusi i tyre.</p>	<p>7. The partnership and grouping of persons responsible for declaring and paying all kinds of taxes, including contributions for employees except the income tax of the partnership and grouping of persons, whose declaration is made by the partnership or grouping of persons and payment is made partners or members of the group, depending on their status.</p>	<p>7. Partnerstvo i grupacija lica odgovorni su da izjave i plaćaju sve vrste poreza, obuhvativši doprinose za zaposlene, osim poreza na prihode partnerstva i grupacije lica, koje deklarirše partnerstvo ili grupacija lica dok isplatu obavljaju partneri ili članovi grupacije zavisno od njihovog statusa.</p>
<p>8. Ortakëria dhe grupimi i personave nuk obligohen të dorëzojnë dhe paguajnë këste paradhënie. Ortakët apo anëtarët e grupit</p>	<p>8. Partnership and grouping of persons are not obliged to submit and pay advance instalments. Partners or members of the</p>	<p>8. Partnerstvo ili grupacija lica nije dužna da dostavi i plati rate avansa. Partneri ili članovi grupacije lica odgovorni su da</p>

<p>janë përgjegjës për të deklaruar dhe paguar sipas nenit 43, paragrafit 2, nënparagrafi 2.2 të Ligjit duke dorëzuar këste paradhënie për të ardhurat nga ortakëria apo grupimi i personave.</p> <p style="text-align: center;">Neni 44 Pagesa e tatimit për veprimtaritë afariste</p> <p>1. Tatimpaguesi me të ardhura bruto vjetore deri në pesëdhjetëmijë euro (50,000€), i cili nuk kërkohet ose nuk ka zgjedhur për të dorëzuar deklaratën vjetore sipas nenit 48 të Ligjit, kryen pagesat tremujore, si në vijim:</p> <p>1.1. Tre përqind (3%) të të ardhurave bruto të pranuar nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale të çdo tremujori, por jo më pak se tridhjeteshtatë pikë pesë euro (37.5€) për tremujor.</p> <p>1.2. Nëntë përqind (9%) të të ardhurave bruto të pranuar, nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tremujori, por jo më pak se tridhjeteshtatë pikë pesë euro (37.5€) për tremujor.</p> <p>1.3. Nëse një tatimpagues i përshkruar në nenin 43, paragrafin 2, nënparagrafin 2.1.3 të Ligjit nuk ka të ardhura në një</p>	<p>group are responsible to declare and pay pursuant to Article 43, paragraph 2, subparagraph 2.2 of the Law by submitting instalment payment for income from the partnership or group of persons.</p> <p style="text-align: center;">Article 44 Payment of taxes for business activities</p> <p>1. A taxpayer with annual gross income of fifty thousand euro (€ 50,000), who is not required or did not chose to submit an annual declaration under Article 48 of the Law, shall perform quarterly payments, as follows:</p> <p>1.1. Three per cent (3%) of the gross income received from trade, transport, agricultural and similar commercial activities by each quarter, but not less than thirty seven point five euro (€37.5) per quarter.</p> <p>1.2. Nine per cent (9%) of the gross income received from services, professional, vocational, entertainment and similar activities for each quarter, but not less than thirty seven point five euro (€37.5) per quarter.</p> <p>1.3. If a taxpayer described in Article 43, paragraph 2, subparagraph 2.1.3 of the Law has no income in a quarterly</p>	<p>izjave i plaçaju kao što je propisano u članu 43, stav 2, podstav 2.2 Zakona predajući rate avansa za prihode od partnerstva ili grupacije lica.</p> <p style="text-align: center;">Član 44 Isplata poreza za poslovne delatnosti</p> <p>1. Poreski obveznik sa godišnjim bruto prihodom do pedeset hiljade (50,000€) evra, koji se ne traži ili nije izabrao da dostavi godišnju izjavu prema članu 48 Zakona, vrši tro mesečne isplate, kao što sledi:</p> <p>1.1. Tri posto (3%) bruto prihoda dobijenih od trgovine, transporta, poljoprivrede i sličnih poslovnih delatnosti svakog tromesečja, ali ne manje od trideset sedam zarez pet evra (37.5€) za tromesečje.</p> <p>1.2. Devet posto (9%) primljenih bruto prihoda, od usluga, stručnih delatnosti, zanata, zabave i slično svakog tromesečja, ali ne manje od trideset sedam zarez pet evra (37.5€) za tromesečje.</p> <p>1.3. Ako neki poreski obveznik opisan u članu 43, stav 2, podstav 2.1.3 Zakona ne stvara prihode tokom jednog</p>
---	---	--

<p>periudhë tremujore, nuk kërkohet pagesë, por obligohet të dorëzojë formularin me pagesë zero.</p> <p>2. Tatimpaguesi dorëzon pasqyrë tremujore të pagesës së tatimit për bizneset e vogla në formatin e përshkruar nga ATK, në njërën nga bankat apo institucionet financiare të autorizuar nga BQK, deri më: 15 Prill, 15 Korrik, 15 Tetor dhe 15 Janar, në lidhje me tremujorët kalendarik përkatës.</p> <p>3. Tatimpaguesi me të ardhura vjetore bruto mbi pesëdhjetëmijë euro (50,000€) dhe ai i cili zgjedh vullnetarisht të tathet në bazë të të ardhurave reale, paguan paradhënie tremujore për Tatimin në të Ardhura Personale, si në vijim:</p> <p>3.1. Një të katërtën (1/4) e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore në vijim, bazuar në të ardhurën e tatueshme të vlerësuar dhe të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit që lidhet me ato të ardhura, në përputhje me legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhura Personale, apo</p> <p>3.2. Për periudhën e dytë dhe periudhat vijuese tatimore për të cilat tatimpaguesi bënë pagesën sipas këtij paragrafi, së paku një të katërtën (1/4) e njëqindëdhjetë përqind (110%) të detyrimit të përgjithshëm tatimor të</p>	<p>period, there is no charge, but is obliged to submit the form with zero charge.</p> <p>2. The taxpayer shall submit a quarterly statement of tax payment for small businesses in the format prescribed by TAK, in one of the banks or financial institutions authorised by the CBK, until 15th of April, 15th of July, 15th of October and 15th of January, regarding respective calendar quarters.</p> <p>3. A taxpayer with annual gross income over fifty thousand euro (€50,000), and the one who chooses voluntarily to be subject to taxation on the basis of real income shall pay quarterly advance payments on Personal Income Tax, as follows:</p> <p>3.1. One quarter (1/4) of the total tax liability for the current tax period based on estimated taxable income reduced by any amount withheld at source during the quarter in respect of such income in accordance with legislation relevant to the Personal Income Tax, or</p> <p>3.2. For the second and subsequent tax periods for which a taxpayer makes payments under this paragraph, at least one quarter (1/4) of one hundred ten per cent (110%) of the total tax liability of the previous period to the current period</p>	<p>tromesečja, ne traži se, ali dužan je da preda obrazac sa isplatom nula.</p> <p>2. Poreski obveznik podnosi tromesečni izveštaj o uplati poreza za mala preduzeća u formatu propisanom od PAK, u jednoj od banaka ili finansijskih institucija ovlašćene od CBK, do 15 aprila, 15 jula, 15 oktobra i 15 januara, u vezi odgovarajućeg kalendarskog tromesečja.</p> <p>3. Poreski obveznik sa godišnjim bruto prihodom većim od pedeset hiljade evra (50,000€) i onaj koji izabere dobrovoljno da se oporezuje na osnovu realnih prihoda, plaća tromesečni avans za Porez na lične dohotke, kao što sledi:</p> <p>3.1. Jednu četvrtinu (1/4) opštih poreskih obaveza za naredni poreski period, na osnovu procenjenih oporezivih dobitaka umanjeni za bilo koji iznos koji je zadržan na izvoru tokom tog tromesečja u vezi tih prihoda i u skladu sa važećim zakonima o porezu na lični dohodak, ili</p> <p>3.2. Za drugi poreski period i naredne periode za koje poreski obveznik vrši isplatu prema ovom stavu, barem jednu četvrtinu (1/4) od sto deset posto (110%) opštih poreskih obaveza prethodnog perioda za trenutni period smanjen za</p>
--	--	--

<p>periudhës paraprake për periudhën aktuale të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit që lidhen me ato të ardhura, në përputhje me legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhura Personale.</p> <p>4. Tatimpaguesi, në vitin e tij të parë, përdor parashikimin për shumën e pagesave paradhënie tremujore duke u bazuar në ¼ e detyrimit tatimor të parashikuar për vitin e parë.</p> <p>5. Tatimpaguesi i cili i nënshtrohet tatuarjes në bazë të të ardhurave reale për periudhën e cila nuk është periudhë e plotë tatimore (tatimpaguesi i ri apo ai i cili brenda periudhës tatimore ndryshon mënyrën e tatuarjes), deklaron dhe paguan këste paradhënie duke filluar nga periudha tremujore në të cilën është bërë regjistrimi apo ndryshimi i mënyrës së deklarimit.</p> <p>6. Për tatimpaguesin që paguan këste paradhënie për vitin e dytë apo vitet tjera vijuese duke u bazuar në detyrimin tatimor të vitit paraprak të rritur për dhjetë përqind (10%), nuk aplikohet ndëshkim në shkallë interesi.</p> <p>7. Për vitin e parë të tatuarjes në të ardhura reale, për tatimpaguesin, pagesat paradhënie të të cilit janë të pamjaftueshme (80% apo më pak e detyrimit të përgjithshëm tatimor, përfshirë edhe këstin</p>	<p>reduced by any amount withheld at source during the quarter related to that income, in accordance with relevant legislation on Personal income Tax.</p> <p>4. A taxpayer, in his first year, uses the forecast for quarterly advance payment amounts based on ¼ of the projected tax liability for the first year.</p> <p>5. A taxpayer who is subject to taxation based on real income for the period which is not a full tax period (new taxpayer or one who changes the way of taxation during the period of taxation) declares and pays the advance instalments starting from the quarterly period in which the recording or change of the method how declaration is made.</p> <p>6. For the taxpayer who pays an advance instalment for the second year or the following years based on prior year tax liability increased to ten per cent (10%), in penalty interest rate shall not apply.</p> <p>7. For the first year of real income taxation, taxpayer, whose advance payments are insufficient (80% or less of the total tax liability, including the fourth quarterly instalment) compared with total tax</p>	<p>bilo koji iznos zadržan na izvoru tokom tromesečja koji je povezan sa tim prihodima, u skladu sa odgovarajućim zakonodavstvom Poreza na lične dohotke.</p> <p>4. Poreski obveznik, tokom godine, koristi prognoze za iznose predujma za tromesečje na osnovu ¼ predviđene poreske obaveze za prvu godinu.</p> <p>5. Poreski obveznik koji podleže oporezivanju na osnovu realnih dohodaka za period koji nije puni poreski period (novi poreski obveznik ili onaj koji menja način oporezivanja tokom perioda oporezivanja) izjavljuje i plaća akontaciju počev od tromesečnog perioda kada je izvršena registracija ili izmena načina deklaracije.</p> <p>6. Za poreskog obveznika koji plaća unapred avans za drugu godinu ili naredne godine na osnovu poreske obaveze prethodne godine povećane za deset procenata (10%), ne primenjuju se stope zatezne kamate.</p> <p>7. Za prvu godinu oporezivanja za relane prihode, za poreskog obveznika, čije isplate avansa su nedovoljne (80% ili manje od opšte poreske obaveze, obuhvativši i četvrtu tromesečnu ratu) u</p>
--	---	---

<p>e katërt tremujor) krahasuar me detyrimin e përgjithshëm tatimor, aplikohen ndëshkime vetëm për tremujorin e fundit të vitit të parë, bazuar në shumat kumulative të kësteve krahasuar me detyrimin vjetor, e jo duke e konsideruar këstin e fundit thjesht si të izoluar.</p>	<p>liability, penalties shall apply only to the last quarter of the first year, based on cumulative instalment amounts compared with annual liability, rather than considering just the last instalment in isolation.</p>	<p>poređenju sa opštom poreskom obavezom, primenjuju se kazne samo za poslednje tromesečje prve godine, na osnovu kumulativnih iznosa u poređenju sa godišnjom obavezom, a ne smatrajući poslednju ratu samo kao izoliranu.</p>
<p>8. Për vitin e dytë të afarizmit dhe vitet tjera vijuese, për tatimpaguesin i cili ka bërë pagesa paradhënie të pamjaftueshme gjatë vitit, aplikohen ndëshkime për çdo këst tremujor deri në datën e dorëzimit të deklaratës vjetore, maksimalisht deri në ditën e fundit të afatit të dorëzimit të deklaratës vjetore.</p>	<p>8. For the second year of business and following years, the taxpayer who has made insufficient advance payments during the year, penalties shall apply to each instalment until the date of submission of the annual declaration, a maximum of the last day of term submission of the annual declaration.</p>	<p>8. Za drugu godinu poslovanja i naredne godine, za poreskog obveznika koji je izvršio nedovoljne isplate avansa u toku godine, primenjuju se kazne za svaku tromesečnu ratu do dana podnošenja godišnje deklaracije, maksimalno do poslednjeg dana roka dostavljanja godišnje deklaracije.</p>
<p>9. Në rastin kur këstet e para janë më të ulëta dhe këstet e më vonshme janë më të larta se sa detyrimi për këst, ndëshkimet aplikohen për këstet e hershme derisa pagesat e tepërta të mëvonshme mbulojnë mungesat e para. Në rastin kur këstet e para janë më të larta dhe këstet e më vonshme janë më të ulëta, mbipagesat mbulojnë diferencat për periudhat e mëvonshme.</p>	<p>9. In case the instalments are lower and later instalments are higher than obligation for instalment, penalties apply for early instalments until later excess payments cover first shortages. When instalments are higher and more recent instalments are lower, overpayments cover differences for periods subsequent.</p>	<p>9. U slučaju kada su prve rate manje i kada su kasnije rate veće od obaveza za plaćanje rate, kazne se primenjuju za ranije rate dok kasnije suvišne isplate pokrivaju prve nedostatke. U slučaju kada su prve rate veće a kasnije rate su manje, doplate pokrivaju razlike za kasnije periode.</p>
<p>10. Kur tatimpaguesi ka pasur humbje në deklaratën tatimore të vitit paraprak, për vitin aktual deklaron dhe paguan këstet tremujore, bazuar në nenin 43, paragrafin 2, nënparagrafin 2.2.1 të Ligjit, pra duke vlerësuar të ardhurat për vitin aktual.</p>	<p>10. When a taxpayer has a tax loss in statement of the previous year, declares for current year and pays quarterly instalments, based on Article 43, paragraph 2, subparagraph 2.2.1 of the Law, thus estimating income for the current year.</p>	<p>10. Kada je poreski obveznik imao gubitka u poreskoj deklaraciji prethodne godine, za tekuću godinu izjavljuje i plaća tromesečne rate, na osnovu člana 43, stav 2, podstav 2.2.1 Zakona, dakle porcenivši prihode za tekuću godinu.</p>
<p>11. Tatimpaguesi i cili vlerëson se në vitin</p>	<p>11. A taxpayer who estimates that in the</p>	<p>11. Poreski obveznik koji procenjuje da će</p>

<p>aktual do të ketë humbje tatimore apo fitim i cili është më i ulët se humbjet e bartura, edhe pse nuk ka obligim për të paguar, deklaron këstet tremujore.</p> <p>12. Tatimpaguesi i cili posedon tepriçë pagese në ndonjë lloj tatimi si dhe i njëjti ka obligim pagese në këstet paradhënie, me kërkesën e tij, ATK do të transferoj shumën e mjeteve tepriçë në obligimet aktuale për këstet paradhënie.</p> <p>13. Kur ATK rivlerëson detyrimin tatimor vjetor i cili është më i lartë se detyrimi vjetor tatimor i vetëvlerësuar nga tatimpaguesi, aplikimi i ndëshkimeve në këstet paradhënie, bëhet si në vijim:</p> <p>13.1. Kur detyrimi tatimor sipas rivlerësimit është jo më i lartë se 20% krahasuar me vetëvlerësimin, nuk aplikohet ndëshkim në këstet tremujore paradhënie, por, ndëshkimet dhe interesi aplikohen vetëm për detyrimin vjetor tatimor;</p> <p>13.2. Kur detyrimi tatimor sipas rivlerësimit është më i lartë se 20% krahasuar me vetëvlerësimin, aplikohet ndëshkim në shkallë interesi në këstet tremujore paradhënie ndërsa ndëshkimet dhe interesi aplikohen në detyrimin vjetor tatimor;</p> <p>13.3. Kur detyrimi tatimor sipas</p>	<p>current year will be have tax loss or profit which is lower than the losses carried forward, although there is no obligation to pay, shall declare quarterly instalments.</p> <p>12. A taxpayer who has surplus in any tax payment and the same is required to make advance payment in instalments, at his request TAK will transfer surplus funds in the amount of current liabilities to advance instalments.</p> <p>13. When TAK reassesses annual tax liability which is higher than the annual tax liability self-assessed by the taxpayer, penalties shall apply in instalments as follows:</p> <p>13.1. When tax liability according to reassessment is not higher than 20% compared with self-assessment, no penalty shall be applied in advance quarterly instalments, but, penalties and interest shall apply only to annual tax liability;</p> <p>13.2. When tax liability according to reassessment is not higher than 20% compared with self-assessment penalties shall apply at interest rate in advance in quarterly instalments and interest and penalties shall be applied in the annual tax liability;</p> <p>13.3. When tax liability according to</p>	<p>u tekuçoj godini biti poreskih gubitaka ili dobitaka koji je manji od prenetih gubitaka, iako ne postoji obaveza plaćanja, izjavljuje tromesečne rate.</p> <p>12. Poreski obveznik koji poseduje višak plaćanja na neku vrstu poreza i ako isti ima obaveze plaćanja avansnih rata, na njegov zahtev, PAK će preneti iznos suvišnih sredstava na trenutne obaveze za avansne rate.</p> <p>13. Kada PAK vrši preispitivanje godišnje poreske obaveze koja je veća od godišnje poreske obaveze procenjene od strane poreskog obveznika, primena kazni u avansne rate, obavlja se kao u nastavku:</p> <p>13.1. Kada poreska obaveza prema preispitivanju nije veća od 20% u poređenju sa samoprocenom, ne primenjuju se kazne na tromesečne rate avansa, ali, kazne i kamate se primenjuju samo za godišnje poreske obaveze;</p> <p>13.2. Kada je poreska obaveza prema revalorizaciji veća od 20% u poređenju sa samoprocenom, primenjuju se kazne u kamatnoj stopi na tromesečne avansne rate dok kazne i kamate se primenjuju na godišnje poreske obaveze;</p> <p>13.3. Kada poreska obaveza</p>
---	--	---

<p>rivlerësimit është jo më i lartë se 20% krahasuar me vetëvlerësimin, nuk kërkohet të bëhet rregullimi i kësteve paradhënie por, konsiderohet se janë brenda opsionit 110%, siç është përcaktuar me nenin 43, paragrafin 2, nënparagrafin 2.2.2.</p> <p>14. Formulari vjetor i Tatimit në të Ardhurat Personale është një deklaratë tatimore ndërsa pasqyrat tremujore të pagesave paradhënie nuk konsiderohen deklaratata tatimore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 45 Pagesa e tatimit për të ardhurat nga qiratë</p> <p>1. Neni 44, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit obligojnë tatimpaguesin që të bëjë pagesa tremujore të Tatimit në të Ardhurat Personale për të ardhurat nga qiraja. Me qëllim të bërjes së këtyre pagesave tremujore, plotëson formularin tremujor për pagesë ashtu siç përcaktohet nga ATK dhe dorëzon formularin dhe pagesën e tatimit në njërën nga bankat apo institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.</p> <p>2. Personi fizik jo afarist i cili është qiradhënës i personit fizik jo afarist apo personit/autoritetit i cili nuk është i</p>	<p>reassessment is not higher than 20% compared with self-assessment, no adjustment is required but advance instalments are considered within the 110% option, as defined in Article 43, paragraph 2, subparagraph 2.2.2.</p> <p>14. Annual Personal Income Tax Form is a tax declaration whilst quarterly advance payment statements are not considered tax declarations</p> <p style="text-align: center;">Article 45 Payment of tax on income from lease</p> <p>1. Article 44, paragraphs 1 and 2 of the Law require from taxpayers to make quarterly payments of personal income tax on income from lease. With the aim of making these payments quarterly, it shall fill out quarterly payment form as prescribed by TAK and submit the form and payment of tax in one of the banks or financial institutions licensed by the Central Bank of Kosovo.</p> <p>2. A natural non-business person who is a lessor of a natural non-business person/authority which is not obliged to</p>	<p>prema revalorizaciji je veća od 20% u poređenju sa samoprocenom, ne traži se prilagođavanje avansnih rata ali, smatraju se u opciji 110%, kao što je određeno u članu 43, stav 2, podstav 2.2.2.</p> <p>14. Godišnji obrazac Poreza na lične dohotke je poreska izjava dok tromesečni izveštaji avansnih plaćanja ne smatraju se kao poreske izjave.</p> <p style="text-align: center;">Član 45 Plaćanje poreza na prihode od zakupnine</p> <p>1. Član 44, stav 1 i 2 Zakona obavezuje poreskog obveznika da izvrši tromesečne isplate Poreza na lične dohotke za prihode od zakupnine. U cilju izvršenja tromesečne isplate poreza, popunjava tromesečni obrazac za plaćanje kao što je propisano od PAK i dostavlja obrazac o isplati poreza u neku od banaka ili finansijskih institucija licencirane od Centralne banke Kosova.</p> <p>2. Neposlovno fizičko lice koji je zakupodavac neposlovnog fizičkog lica ili osobe/autoriteta koji nije dužan da zadrži</p>
---	---	---

<p>obliguar të mbajë tatimin në burim për qira, obligohet të deklarojë dhe paguaj tatimin në qira, ashtu siç është përcaktuar në nenin 44 të Ligjit. Qiradhënësit i lejohej një zbritje nga të ardhurat bruto nga qiraja në një shumë të barabartë me dhjetë për qind (10%) të qirasë, siç është paraparë në nenin 27 të Ligjit.</p>	<p>withhold tax at source for lease is required to declare and pay tax on lease, as defined in Article 44 of the law. A deduction from gross income on lease shall be allowed to the Lessor, an amount equal to ten per cent (10%) of the lease, as foreseen in Article 27 of the Law.</p>	<p>porez na izvoru za zakupninu, dužan je da izjavi i plati porez za zakupninu, kao što je propisano u članu 44 Zakona. Zakupodavcu se dozvoljava odbitak na bruto prihode od zakupnine u jednakom iznosu od deset posto (10%) zakupnine, kao što je predviđeno u članu 27 Zakona.</p>
<p>3. Në rastet kur personi fizik jo afarist është qiradhënës obligohet të deklarojë të ardhurat e tij nga qiraja duke zbritur shumën e tatimit të mbajtur në burim nga personi afarist, i cili është i obliguar të mbajë tatimin në burim në qira.</p>	<p>3. When a non-business natural person is a lessor, he is required to declare his income from lease by deducting the amount of tax withheld at source from the business person, who is obliged to withhold tax at source on lease.</p>	<p>3. U slučaju kada je neposlovno fizičko lice zakupodavac dužan je da izjavi njegove prihode od zakupa odbijanjem iznosa poreza po odbitku od strane poslovnog lica, koji je dužan da zadrži porez na izvoru o zakupu.</p>
<p>4. Personi fizik afarist me të ardhura bruto vjetore deri në pesëdhjetëmijë euro (50,000€) dhe që nuk ka zgjedhur të tathet në bazë të të ardhurave reale, që ka më shumë se një veprimtari biznesi, prej të cilave njëra veprimtari është dhënia me qira, obligohet që për të ardhurat e tij nga qiradhënia të deklarojë dhe paguaj sipas nenit 43, paragrafit 2, nënparagrafit 2.1.2 të Ligjit, duke zbritur tatimin që i është mbajtur në burim në qira.</p>	<p>4. A natural business person with annual gross income of fifty thousand euros (€50,000) and who did not chose to be taxed on the basis of real income, which has more than one business activity, one of which is leasing activities, shall be required to declare and pay his income from leasing pursuant to article 43, paragraph 2, subparagraph 2.1.2 of the Law, by deducting the withheld source tax on lease.</p>	<p>4. Poslovno fizičko lice sa godišnjim bruto prihodom do pedeset hiljade evra (50,000€) i nije izabrao da se oporezuje na osnovu relanih prihoda, koji ima više od jedne poslovne delatnosti, od kojih je jedna od delatnosti izdavanje pod zakup, dužan je da njegove prihode od zakupnine prijavi i plati u skladu sa članom 43, stav 2, podstav 2.1.2 Zakona, oduzimanjem poreza po odbitku za zakupninu.</p>
<p>5. Personi fizik afarist me të ardhura bruto vjetore deri në pesëdhjetëmijë euro (50,000€) dhe që nuk ka zgjedhur të tathet në bazë të të ardhurave reale, realizon edhe të ardhura nga qiradhënia prej pasurisë e cila nuk është në emër të biznesit, i lejohej një zbritje për të ardhurat bruto nga qiraja</p>	<p>5. A natural business person with annual gross income of fifty thousand euros (€50,000) and who did not chose to be taxed on the basis of real income, the income earned from the lease of property which is not on the business name, a deduction to gross income from lease shall</p>	<p>5. Poslovno fizičko lice sa godišnjim bruto prihodom do pedeset hiljade evra (50,000€) i koji nije izabrao da se oporezuje na osnovu realnih prihoda, realizuje i prihode od zakupnine od imovine koja nije na ime biznisa, dozvoljava mu se odbitak za bruto prihode</p>

<p>në një shumë të barabartë me dhjetë përqind (10%) të qirasë, siç është përcaktuar në nenin 27 të Ligjit. Tatimpaguesi obligohet që për të ardhurat e tij nga qiradhënia të deklarojë dhe paguaj sipas nenit 44, paragrafit 2, të Ligjit, duke zbritur tatimin që i është mbajtur në burim në qira.</p> <p>6. Personi fizik afarist me të ardhura bruto vjetore mbi pesëdhjetëmijë euro (50,000€) apo që ka zgjedhur të tatóhet në bazë të të ardhurave reale, që ka më shumë se një veprimtari biznesi, prej të cilave njëra veprimtari është dhënia me qira, obligohet që për të gjitha të ardhurat e tij të deklaroj dhe paguaj ashtu siç është përcaktuar në nenin 43, paragrafin 2, nënparagrafin 2.2 të Ligjit.</p> <p>7. Personi fizik afarist me të ardhura bruto vjetore mbi pesëdhjetëmijë euro (50,000€) apo që ka zgjedhur të tatóhet në bazë të të ardhurave reale, realizon edhe të ardhura nga qiradhënia prej pasurisë e cila nuk është në emër të biznesit, i lejohet një zbritje për të ardhurat bruto nga qiraja në një shumë të barabartë me dhjetë përqind (10%) të qirasë, siç është paraparë në nenin 27 të Ligjit. Tatimpaguesi i tillë, për të gjitha të ardhurat e tij deklaron dhe paguan sipas nenit 43, paragrafit 2, nënparagrafin 2.2 të Ligjit.</p>	<p>be allowed on amount equal to ten per cent (10%) of the lease, as defined in Article 27 of the Law. The taxpayer is required to declare and pay his income from leasing pursuant to article 44, paragraph 2, of the Law, by deducting the withheld source tax on lease.</p> <p>6. A natural business person with annual gross income over fifty thousand euro (€50,000) or the one who has chosen to be taxed on the basis of real income, which has more than one business activity, one of which is leasing activities, is required for to declare and pay all his income as defined in Article 43, paragraph 2, subparagraph 2.2 of the Law.</p> <p>7. A natural business person with annual gross income over fifty thousand euro (€50,000) or the one who has chosen to be taxed on the basis of real income, the income earned from the lease of property which is not on the business name, a deduction to gross income from lease shall be allowed on amount equal to ten per cent (10%) of the lease, as defined in Article 27 of the Law. The taxpayer is required to declare and pay his income from leasing pursuant to article 44, paragraph 2, of the Law.</p>	<p>od zakupnine u jednakom iznosu sa deset posto (10%) zakupa, kao što je propisano u članu 27 Zakona. Poreski obveznik je dužan da za njegove prihode od zakupa izjavi i plati prema članu 44, stav 2, Zakona, oduzimanjem poreza po odbitku za zakupninu.</p> <p>6. Poslovno fizičko lice sa godišnjim bruto prihodom iznad pedeset hiljada evra (50,000€) ili koji je izabrao da se oporezuje na osnovu realnih prihoda, koji ima više od jedne poslovne delatnosti, od kojih jedna od delatnosti je izdavanje zakupa, dužan je da za sve njegove prihode izjavi i plati onako kako je propisano u članu 43, stav 2, podstav 2.2 Zakona.</p> <p>7. Poslovno fizičko lice sa godišnjim bruto prihodom iznad pedeset hiljade evra (50,000€) ili koji je izabrao da se oporezuje na osnovu realnih prihoda, realizuje i druge prihode od zakupnine od imovine koja nije na ime biznisa, dozvoljava mu se odbitak za bruto prihode od zakupnine u iznosu koji je jednak sa deset posto (10%) zakupnine, kao što je predviđeno prema članu 27 Zakona. Takav poreski obveznik, za sve njegove prihode izjavljuje i plaća prema članu 43, stav 2, podstav 2.2 Zakona.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 46 Pagesa e tatimit për pasurinë e paprekshme</p> <p>Neni 45, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit obligojnë tatimpaguesin që të bëjë pagesa tremujore të Tatimit në të Ardhurat Personale për të ardhurat nga pasuria e paprekshme. Deklarimi dhe pagesa bëhet në formën e përcaktuar nga ATK në njërën nga bankat apo institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 46 Payment of tax for intangible property</p> <p>Article 45, paragraphs 1 and 2 of the Law requires from taxpayers to make quarterly payments of personal income tax on income from intangible property. The declaration and payment shall be made in the form prescribed by TAK in one of the banks or financial institutions licensed by the Central Bank of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;">Član 46 Isplata poreza za nepokrentu imovinu</p> <p>Član 45, stav 1 i 2 Zakona obavezuje poreskog obveznika da izvrši tromesečnu isplatu Poreza na lične dohotke od nepokretne imovine. Izjava i isplata obavljaju se u formi koja je propisana od strane PAK u jednu od banaka ili finansijskih institucija licencirane od strane Centralne banke Kosova.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 47 Pagesa e tatimit për të ardhurat nga fitimet kapitale, dhuratat, fitoret në lotari dhe fitoret në lojërat e fatit dhe çdo burim tjetër</p> <p>Neni 46 i Ligjit, obligon tatimpaguesit të cilët realizojnë të ardhura nga fitimet kapitale, dhuratat, fitoret në lotari dhe fitoret në lojërat e fatit dhe çdo burim tjetër, të dorëzojnë deklaratë vjetore tatimore dhe të paguajnë tatimin deri më 31 mars të vitit vijues që pason periudhën tatimore. Deklarata tatimore dorëzohet në mënyrën dhe formatin e përcaktuar nga ATK, ndërsa pagesa e tatimit bëhet në njërën nga bankat apo institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 47 Payment of tax on income from capital gains, gifts, lottery winnings and gambling winnings and any other source</p> <p>Article 46 of the Law requires from taxpayers who earn income from capital gains, gifts, lottery winnings and gambling winnings and any other source, to submit an annual tax declaration and pay taxes until 31st of March of the following year following tax period. The tax declaration shall be submitted in the manner and format prescribed by TAK and tax payments shall be made in one of the banks or financial institutions licensed by the Central Bank of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;">Član 47 Isplate poreza za prihode od kapitalnih dobitaka, poklona, dobitak na lutriji i dobitak u igrama na sreću i bilo koji drugi izvor</p> <p>Član 46 Zakona, obavezuje poreske obveznike koji realizuju prihode do kapitalnih dobitaka, poklone, dobitak na lutriji i dobitak u igrama na sreću ili bilo koji drugi izvor, da dostave godišnje poreske izjave i da plaćaju porez do 31 marta naredne godine nakon poreskog perioda. Poreska izjava dostavlja se na način i u formatu koji je propisan od PAK, dok isplata poreza se obavlja u neku od banaka ili finansijskih institucija licencirane od Centralne banke Kosova.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 48 Deklaratat tatimore dhe pagesat</p>	<p style="text-align: center;">Article 48 Tax declarations and payments</p>	<p style="text-align: center;">Član 48 Poreska izjava i isplate</p>
<p>1. Deklarata vjetore e Tatimit në të Ardhura Personale dorëzohet në mënyrën dhe formatin e përcaktuar nga ATK, ndërsa pagesa e tatimit bëhet në njërën nga bankat apo institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.</p> <p>2. Në rastin kur data specifike e deklarimit apo pagesës nuk është ditë pune, këto forma dhe/ose pagesa dorëzohen më së voni në ditën e parë të punës që pason pas asaj dite.</p> <p>3. Tatimpaguesi i cili realizon të ardhura nga një a më shumë burime, siç është përcaktuar në nenin 48, paragrafin 2 të Ligjit, me përjashtim të të ardhurave të parapara në nënparagrafët 2.2 dhe 2.3, mund të dorëzoj deklaratë vjetore.</p> <p>4. Përjashtim nga paragrafi 3 i këtij neni, tatimpaguesi i cili realizon të ardhura vetëm nga fitoret në lotari dhe fitoret në lojërat e fatit siç është paraparë në nenin 48, paragrafin 2, nënparagrafin 2.5 të Ligjit, deklaron të ardhurat e tij në pajtim me paragrafin 1 të nenit 48 të Ligjit.</p>	<p>1. Annual Statement of Personal Income Tax shall be submitted in the manner and format prescribed by TAK and tax payments shall be made in one of the banks or financial institutions licensed by the Central Bank of Kosovo.</p> <p>2. When the specific date of declaration or payment is not a working day, these forms and/or payment shall be submitted at the latest on the first working day following the day after.</p> <p>3. A taxpayer who earns income from one or more sources, as defined in Article 48, Paragraph 2 of the Law, with the exception of income stipulated in sub-paragraphs 2.2 and 2.3, may submit an annual declaration.</p> <p>4. Notwithstanding paragraph 3 of this Article, the taxpayer who earns income only from lottery winnings and gambling winnings as provided in Article 48, paragraph 2, subparagraph 2.5 of the Law declares his income in accordance with paragraph 1 of Article 48 of the Law.</p>	<p>1. Godišnja izjava Poreza na lične dohotke dostavlja se na način i u formatu koji su propisani od PAK, dok se isplate poreza obavljaju u neku od banaka ili finansijskih institucija licencirane od Centralne banke Kosova.</p> <p>2. U slucaju kada specifični datum izjave ili isplate nije radni dan, ove forme i/ili isplate dostavljaju se najkasnije na prvi radni dan koji sledi nakon tog dana.</p> <p>3. Poreski obveznik koji realizuje prihode sa jednog ili više izvora, kao što je određeno u članu 48, stav 2 Zakona, sa izuzetkom prihoda koji su predviđeni u podstavu 2.2 i 2.3, može da dostavi godišnju izjavu.</p> <p>4. Izuzetak iz stava 3 ovog člana, poreski obveznik koji realizuje prihode samo od dobitka na lutriji i igara na sreću kao što je predviđeno u članu 48, stav 2, podstav 2.5 Zakona, izjavljuje njegove prihode u skladu sa stavom 1 člana 48 Zakona.</p>

<p>5. Tatimpaguesi i cili realizon të ardhura nga dhuratat, fitimet kapitale apo ndonjë burim i ngjashëm siç është paraparë në nenin 46, të Ligjit, deklaror të ardhurat e tij në pajtim me nenin 48 të Ligjit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 49 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë ditë pas nënshkrimit.</p> <p style="text-align: right;">AVDULLAH HOTI</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p style="text-align: right;">Ministër i Financave Datë: 15/03/2016</p>	<p>5. A taxpayer who earns income from gifts, capital gains or any similar source as foreseen in Article 46 of the Law declares his income in accordance with Article 48 of the Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 49 Entry into force</p> <p>This Administrative Instruction shall enter into force seven days from its signature.</p> <p style="text-align: right;">AVDULLAH HOTI</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p style="text-align: right;">Minister of Finance Date: 15/03/2016</p>	<p>5. Poreski obveznik koji realizuje prihode od poklona, kapitalnih dobitaka ili sa nekog sličnog izvora kao što je predviđeno u članu 46, Zakona, izjavljuje njegove prihode u skladu sa članom 48 Zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 49 Stupanje na snagu</p> <p>Ovo Administrativno uputstvo stupa na snagu sedam dana nakon potpisivanja.</p> <p style="text-align: right;">AVDULLAH HOTI</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p style="text-align: right;">Ministar finansija Datum: 15/03/2016</p>
---	---	--